

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**

**STRATEGJIA KOMBËTARE E MBROJTJES SOCIALE**

**2015-2020**

	Faqe
HYRJE	3
I. KUSHTET AKTUALE	5
1. Varfëria dhe skema e Ndhmës Ekonomike	5
2. Aftësia e kufizuar	11
3. Shërbimet e Kujdesit Shoqëror	14
II. VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE	17
1. Vizioni	18
2. Politikat	18
3. Qëllimet strategjike	19
III. OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE PRODUKTET MADHORE	20
A. Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë	20
B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara	23
C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social	24
IV. BURIMET FINANCIARE	27
V. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE	29

## **HYRJE**

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020, në vijim strategjia, adreson çështjet në fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) në lidhje me (i) skemën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, (ii) shërbimet e kujdesit shoqëror ekzistuese dhe ato të propozuara dhe (iii) çdo çështje tjetër në fushën e mbrojtjes sociale.

Strategjia konsolidon dhe krijon vazhdimësi të strategjisë së mëparshme, duke kombinuar përpjekjet për mbrojtje sociale në një kuadër të unifikuar. Strategjia zëvendëson Strategjinë e Mbrojtjes Sociale 2007-2013. Ky dokument përbën bazën për komponentin e Mbrojtjes Sociale të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2015-2020). Synimet strategjike të Mbrojtjes Sociale të përcaktuara këtu janë gjithashtu të ndërthurura më gjerë në përbërës të tjerë të SKZHI-së. Strategjia është hartuar bazuar në një proces të gjerë dhe të detajuar këshillimesh.

Strategjia reflekton angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale duke synuar që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore.

Kjo strategji hartohet në përputhje me nenet 70 dhe 99 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Dokumentit të Partneritetit 2007 dhe përmbush detyrimet që burojnë nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2014-2020.

Strategjia synon reformimin e Programit të Mbrojtjes Sociale nëpërmjet transformimit të Ndihmës Ekonomike në një skemë aktive të riintegritit social; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë kufizuar; ndërhyrjes dhe riintegritit të fëmijëve në familje e komunitet duke treguar kujdes të veçantë për fëmijët jetimë social dhe biologjikë dhe ofrimin e shërbimeve të integruara. Prioritet është sigurimi i burimeve të nevojshme për grupet më të rrezikuara nëpërmjet Fondit Kombëtar për Shërbimet Shoqërore dhe Fondeve Rajonale për Shërbimet Shoqërore si pjesë e Fondit Shoqëror.

MMSR konfirmon sërish në strategji angazhimin për krijimin e sinergjive midis politikave aktive të punësimit dhe përfshirjes sociale, në mënyrë që të gjithë qytetarët shqiptarë të jenë të siguar, të mbrojtur nga rreziku i rënies në gjendjen e varfërisë, përgjatë periudhave aktive dhe joaktive të jetës. Strategjia synon të integrojë më mirë aktivitetet e mbrojtjes sociale të MMSR dhe funksioneve të saj në lidhje me punësimin, pensionet dhe sigurimet shoqërore.

Zbutja e varfërisë është një çështje shumë më e gjerë se sa vetëm mbrojtja sociale. Politikat e mbrojtjes sociale mund të kontribuojnë në uljen e varfërisë, e cila është një objektivi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Në kontekstin e përgjithshëm ekonomik, politikat e punësimit janë vendimtare për uljen e nivelit të varfërisë në Shqipëri.

Zbutja e varfërisë nuk lidhet vetëm me pagesat dhe me shërbimet e kujdesit shoqëror, por edhe me një gamë të gjerë të politikash të tjera, duke përfshirë, në veçanti ato të lidhura me kujdesin shëndetësor dhe me arsimin. MMSR do të punojë ngushtë në zbatimin e strategjive ndër-sektoriale në mënyrë që të adresojë çështjet e varfërisë dhe përjashtimit social, siç është dokumenti për politikën e përfshirjes sociale.

Politikë kyçe e Mbrojtjes Sociale është përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara. Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një reformë të procesit të vlerësimit të

aftësisë së kufizuar, i cili synon të përqendrojë pagesat e aftësisë së kufizuar tek personat me aftësi të kufizuar më të rëndë. Objektivi i përgjithshëm i reformës është krijimi i një sistemi të përgjegjshëm të pagesave të aftësisë së kufizuar, me qëllim vlerësimin e përshkallëzuar të aftësisë së kufizuar, në varësi të shkallës së sëmundjes dhe kushteve sociale. Reforma e shërbimeve të kujdesit social do të ofrojë mbështetje për personat me aftësi të kufizuara për të mbështetur nevojat shtesë që dalin nga aftësia e kufizuar dhe kostot e tyre të mundshme.

Shërbimet e përkujdesit shoqëror luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetesës të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë. *Vizioni ynë për këto shërbime është një sistem i integruar përkujdesi shoqëror që është koherent dhe i qëndrueshëm në nivel strategjie, politikash, buxhetesh dhe kapacitetesh*

Qasjet e ndjekura në Strategjitë e mëparshme me përfshirjen e shumë agjencive, janë bazuar në prioritizimin e grupeve të caktuara, të identifikuar si të rrezikuara apo të pambrojtura. Kjo mund të jetë efektive në përcaktimin e proceseve të koordinimit në nivel kombëtar për këto grupe. Megjithatë, kompleksiteti i përjashtimit mund të orientojë drejt politikave të fragmentuara dhe gjithnjë më pak koherente në kontekstin e rritjes së delegimit/decentralizimit të kompetencave. Kjo çon në fragmentim të mëtejshëm dhe rritje të kostove duke rrezikuar zbatimin e këtyre politikave të mbrojtjes sociale.

Strategjia paraqet një vizion të qëndrueshëm, koherent për mbrojtjen sociale bazuar në qasjen e *ciklit te jetës*. Qasja strategjike trajton çështje thelbësore dhe shenjëstron rreziqet dhe problemet e tyre gjatë gjithë fazave të jetës: në vitet e hershme të fëmijërisë, fëmijët, moshë pune, të moshuarit dhe komuniteti.

Qasja e *ciklit te jetës* paraqet një vizion të përmirësuar dhe mundëson përfshirje më të madhe, duke ofruar një kuadër më unitar dhe të integruar, i cili lidhet qëllimet e mbrojtjes dhe përfshirjes aktive sociale të vendeve të BE-së. Ajo e vendos individin në qendër të zhvillimit të politikave dhe shërbimeve, duke siguruar që iniciativat publike të bazohen tek nevojave reale.

Vlera e shtuar e kësaj qasjeje është shenjëstrimi individit në kompleksitetin e nevojave që ka. Një person me aftësi të kufizuara është para së gjithash një fëmijë apo një i rritur me nevoja të veçanta dhe përballet me pengesa njësoj si individët e tjerë të së njëjtës grup moshe. Kjo qasje mundëson hartimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe koherente.

Qasja e *ciklit të jetës*:

- tregon se çfarë duhet të bëhet për të trajtuar të përbashkëtat në dimensionet e shumta të përjashtimit social për individët në fazat e ngjashme të jetës;
- merr në konsideratë dimensionet e rrezikut social dhe mënyrat në të cilat ky mund të zhvillohet dhe ndryshojë me kalimin e kohës;
- është një kornizë fleksibël logjike në të cilën rreziqet e reja dhe modelet sociale janë të përfshira lehtë;
- ndihmon të krijojë imazhin e përjashtimit social dhe pengesën si një “proces”, shpesh i vetë-përfshirë, i cili shtjellohet gjatë jetës së individit;
- lehtëson identifikimin e pikave kritike të ndërhyrjes, të tilla si pikat e tranzicionit në të gjithë ciklin e jetës;
- thekson rolin e një game të gjerë të strukturave sociale të përfshira në krijimin e përjashtimit<sup>1</sup>;

---

<sup>1</sup> Për shembull se si mjedisi përreth dhe ndikimi i transportit mbi aftësinë e kufizuar, ose shkaqet e braktisjes në arsim ndikojnë në përjashtimin e individit.

- sqaron se kush do të kryejë një veprim dhe për kë, duke ndihmuar në krijimin e roleve të qarta për personat përgjegjës;
- siguron mbikëqyrjen se ku dhe për kë shpërndahen burimet dhe ku shtrihen prioritetet në të gjithë ciklin e jetës.

Përfshirja social shfaqet në mënyra të ndryshme dhe mund të shkaktohet nga shumë faktorë dhe kjo e bën të vështirë për t'u trajtuar. Për çdo grup dhe lloj përfshirje, do të caktohet se kush është përgjegjës, cilat janë ndërhyrjet e ndërmarra, si kombinohen çështjet dhe mënyra më e mirë se si aktorët mund të bashkëpunojnë për të trajtuar përfshirjen. Kjo kërkon identifikimin e përbashkësive, mënyrat e përfshirjes dhe koordinimin e përpjekjeve në çdo fazë të ciklit jetësor që mundet të trajtohen më pas në politikë.

Qasja e *ciklit te jetës* përqendron politikë-bërësit pikërisht në anën e kërkesës dhe ndryshon nga strategjia e mëparshme që u udhëhoq nga ana e ofertës. Në këtë mënyrë reduktohet fragmentimi dhe boshllëqet e politikave të cilat mund të çojnë uljen e ndikimit të politikës dhe programit të Mbrojtjes Sociale.

Lidhjet midis mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale duhet të jenë të thjeshta dhe të vendosura në mënyrë të qartë. Kjo është trajtuar në *Dokumentin e Politikave mbi Përfshirjen Sociale*. Ky vizion përcakton rolet dhe përgjegjësitë e qarta për të përmirësuar qeverisjen e përfshirjes dhe mbrojtjes.

Një qeverisje e mirë duhet të mbështesë ndryshimet që nxisin rezultate pozitive, diversifikimin dhe pluralitetin e tregut në iniciativat sociale. Politika koherente dhe bashkëpunim ndërinstitucional do të jenë të nevojshme në të gjithë sektorët përkatës të Qeverisë Shqiptare.

Strategjia përcakton një kornizë monitorimi, e cila do të integrohet plotësisht me treguesit BE-SILC, duke ofruar bazën më të mirë për vlerësimin afatgjatë të efikasitetit strategjik dhe programor në drejtim të produkteve dhe efekteve.


## I. KUSHTET AKTUALE

**1. Varfëria dhe skema e Ndihmës Ekonomike.** Treguesit e varfërisë kanë pësuar rritje në vend, nga 12.4% në 2008 në 14.3% në vitin 2012<sup>1</sup>, pasojë kjo e krizës financiare globale. Varfëria rurale është rritur nga 14.6% në 2008 në 15.3% në vitin 2012, ndërsa varfëria urbane u rrit nga 10.1% në 13.6%. Vlerat e varfërisë në zonat malore kanë pësuar rënie (në 15.3%), ndërkohë që në zonat bregdetare (17.6%), qendrore (12.5%) dhe Tiranë (12.6%) u rritën. Varfëria e *skajshme* (personat me vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë ushqimore) pësoi rritje në nivel kombëtar gjatë viteve 2008 – 2014, përkatësisht nga 1.2% në 2.2%.

---

<sup>1</sup> INSTAT, *Shqipëria: Trendi I varfërisë*, 2013.

Figura 1: Varfëria sipas rajoneve, 2008-2012 (%)



Burimi: INSTAT “Treguesit e varfërisë sipas rajoneve” të dhëna online

Hendeku i varfërisë ka pësuar rritje gjatë viteve 2008 – 2012, përkatësisht nga 2.3% në 2.9%. Në vitin 2008 hendekun më të lartë të varfërisë e kishin rajonet malore, ndërsa në vitin 2012 rajonet bregdetare.

Varfëria është e lidhur me një shumëllojshmëri shkaqesh, duke përfshirë gjendjen e tregut të punës (papunësisë dhe pasivitetit), strukturën e moshës së popullatës, pozitën gjeografike, etnike, nivelin e arsimit dhe faktorë të tjerë<sup>1</sup>. Të dhënat në dispozicion tregojnë se grupet e popullatës që ballafaqohen me rrezik më të lartë të varfërisë janë të papunët, më pak të arsimuarit, personat që jetojnë në zonat rurale dhe ata të angazhuar në bujqësi për nevoja personale<sup>2</sup>.

Njerëzit që punojnë mund të jenë gjithashtu të varfër, nëse ata punojnë për paga shumë të ulëta. "Të varfrit që punojnë" fitojnë rreth 17% më pak se “jo të varfrit që punojnë”<sup>3</sup>. Kur të varfrit që punojnë janë punësuar në sektorin informal, ata nuk gëzojnë as të drejtat nga sigurimet shoqërore. Mungesa e sigurimeve shoqërore ndikojnë edhe në perspektivën për një pension të mjaftueshëm. Mesatarisht, vetëm pak më shumë se dy të pestat (44%) e të varfërve të punësuar kanë të drejtë për përfitimet e sigurimeve shoqërore, në krahasim me pothuajse tre të katërtat (72%) të jo të varfërve të punësuar<sup>4</sup>.

Skema e Ndhmës Ekonomike (NE) është instrumenti kryesor për “zbutjen e varfërisë” në vend, edhe pse aktualisht ka një ndikim të kufizuar në varfëri<sup>5</sup>. Aktualisht janë rreth 80.000 familje të cilët përfitojnë pagesat e NE. Skema e NE-së shenjëstron relativisht mirë familjet e varfra, pasi pjesa më e varfër e popullsisë (20% ose kuintili më e varfër i popullsisë në vend,

<sup>1</sup> UNDP (2011) *Report on Vulnerable Groups Excluded from the Labour Market*, Tirana: ILO and UNDP.

<sup>2</sup> MMSR, 'Strategjia e Punësimit dhe Aftësive' 2014-2020', 2014, fq. 6

<sup>3</sup> MMSR, 'Strategjia e Punësimit dhe Aftësive' 2014-2020', 2014, fq.6-7

<sup>4</sup> MMSR, 'Strategjia e Punësimit dhe Aftësive' 2014-2020', 2014, fq. 6-7

<sup>5</sup> Skema e aftësisë së kufizuar gjithashtu luan një rol të rëndësishëm por është më pak e përqendruar mbi varfërinë dhe është trajtuar më poshtë.


por brenda këtij grupi jo të gjithë mund të konsiderohen të varfër) përfiton 56% të shpenzimeve të skemës.

Treguesit e mbulimit dhe shenjëstrimit të familjeve të varfra nga skema duhet të përmirësohen, përfitimet janë të ulëta dhe administrimi është jo-efikas. Skema arrin të mbulojë me pagesa 24.6% të varfërve ekstreme, 19.5% të varfërve total dhe 5.6% e popullsisë jo të varfër arrin të përfitojë këto pagesa.

Pagesat e NE-së, pas transferimit, mbulojnë rreth 15 për qind të shpenzimeve të konsumit të familjeve përfituese në kuintilin më të varfër. Pagesa mesatare e tanishme e NE-së është rreth 3.800 – 4.200 lekë në muaj. Kjo do të thotë se pagesa aktualisht ka një ndikim të kufizuar në uljen e varfërisë<sup>1</sup>.

Shpenzimet për NE janë rritur në vlerë absolute gjatë dekadës së fundit, por kanë rënë krahasuar me përqindjen që zënë në PBB-së. Po kështu numri i familjeve që marrin NE ka rënë me pothuajse një e treta (31.6%), me një rënie sidomos në 2014, që korrespondon me reformimin e skemës së Ndihmës Ekonomike në tre rajonet pilot.

Figura 2: Numri përfituesve dhe shpenzimet për skemën NE dhe Pagesat për Aftësinë e Kufizuar (PAK), 2005-2014



Aktualisht, pagesat e NE-së kanë një ndikim të kufizuar në varfëri dhe zbutja e varfërisë nuk varet vetëm nga një shenjëstrim më efikas<sup>2</sup>. Gjithsesi, masa e pagesës ka pësuar rritje gjatë viteve, ku ndër të tjera rritja indekskohet me inflacionin. Së fundmi janë shtuar edhe disa

<sup>1</sup> Shikoni URI / NCSS, Reforming Economic Aid: from survival to investment in poverty reduction, UNICEF, 2011.

<sup>2</sup> URI / NCSS, Reforming Economic Aid: from survival to investment in poverty reduction, UNICEF, 2011.

pagesa shtesë “të kushtëzuara” për ndjekjen e shkollës dhe vaksinimin e fëmijëve të familjeve përfituese dhe zbatimi i tyre do të vlerësohet nga MMSR-ja.<sup>1</sup>

Qeveria është duke zbatuar një reforme të gjerë të skemave të NE dhe PAK me mbështetjen e Projektit për Modernizimin e Asistencës Sociale (PMAS) të Bankës Botërore<sup>2</sup>. PMAS mbështet zbatimin e reformave në Shqipëri për të rritur efikasitetin dhe barazinë në akses dhe transparencën e skemave të NE dhe PAK.

PMAS përbëhet nga 2 pjesët e mëposhtme<sup>3</sup>:

*Pjesa 1: Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale. Mbështetja e zbatimit të përmirësuar si e programit të ndihmës ekonomike edhe e programit të aftësisë së kufizuar nëpërmjet dhënies së financimit për rimbursimin e pagesave që Huamarrësi ka bërë nga alokimet e tij buxhetore për programin e ndihmës ekonomike (pagesat për programin e miratuar të shpenzimeve).*

*Pjesa 2: Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e ndihmës sociale Realizimi i aktiviteteve të mëposhtme për forcimin e kapacitetit të Huamarrësit për zbatimin e përmirësimeve në dhënien e përfitimeve të ndihmës sociale:*

*a) Dhënia e asistencës teknike për rishikimin e parametrave të programeve të ndihmës sociale, duke përfshirë: rishikimin e kriterëve të vlerësimit për ndihmën e aftësisë së kufizuar; përfshirjen e përvojës ndërkombëtare; rishikimin e procedurave të biznesit dhe marrëveshjeve institucionale; dhe përditësimin e formulës së unifikuar të pikëzimit (e cila ndihmon në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përftimin e ndihmës ekonomike).*

*b) Dhënia e asistencës teknike për mbështetjen e zhvillimit të një sistemi të informacionit për menaxhimin, duke përfshirë: rishikimin e procedurave thelbësore të biznesit, rolet institucionale dhe kërkesat funksionale për të përcaktuar produktet për projektimin e sistemit të informacionit për menaxhimin; zhvillimin e sigurimit të cilësisë për ngritjen dhe zbatimin e sistemit të informacionit për menaxhimin; zhvillimin e një politike të rishikuar të sanksioneve dhe mekanizmave të zbatimit për të forcuar aftësitë për të zgjidhur ligjërisht abuzimet; dhe hartimin e instrumenteve për zbulimin e abuzimet, dhe mekanizmat e tjerë të inspektimit social.*

*c) Dhënia e asistencës teknike për promovimin e transparencës në komunikime dhe monitorim dhe vlerësim, duke përfshirë:*

*i) nxitjen e ndërgjegjësimit, të kuptuarit dhe pranimit të reformave në NE dhe PAK, nëpërmjet hartimit, ndër të tjera, të një strategjie gjithëpërfshirëse komunikimi dhe të mjeteve specifike të komunikimit të përshtatura për temat dhe grupet e synuara specifike; dhe*

*ii) forcimin e monitorimit dhe të vlerësimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit, ndër të tjera, të një procesi për vlerësimin e reformave në NE dhe PAK dhe zbatimin e një studimi në ndjekje të aftësisë së kufizuar për të mbështetur monitorimin e reformave të ndihmës së aftësisë së kufizuar.*

*d) Ofrimi i mbështetjes së zbatimit të projektit nëpërmjet financimit të kostove operative dhe dhënies së konsulencës për të përmirësuar ekspertizën teknike të MPÇSSH-së në fusha që*

<sup>1</sup>Kjo përfshin pagesën shtesë 300 LEK për fëmijën që shkon në shkollë dhe 100 LEK për vaksinimin.

<sup>2</sup> Banka Botërore, Projekti për Modernizimin e Asistencës Sociale

<sup>3</sup> Ligj nr. 84/2012, datë 18 shtator 2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale”



*përfshijnë: menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e përditshëm të projektit, prokurimet dhe menaxhimin financiar.”*

Dy ndër elementet kryesore të PMAS në mbështetje të reformës janë krijimi i regjistrin kombëtar elektronik të NE dhe përzgjedhja e përfituesve nëpërmjet formulës së pikëzuar<sup>1</sup>, ku kriteret e përfitimit vlerësohen sipas nevojave dhe mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke dhënë pesha specifike të qarta, objektive dhe transparente.

Zbatimi i PMAS përfshin fazën e parë të krijimit regjistrin kombëtar të NE, që është një sistemi elektronik për menaxhimin e informacioni, me anë të cilit synohet një përzgjedhje më e drejtë të familjeve përfituese, rritje të efikasitetit dhe transparencës së proceseve të aplikimit, lëshimit të pagesës dhe raportimit. Regjistri i NE është duke u përdorur për procesin e aplikimit, kontrollin e kryqëzuar të informacionit, përzgjedhjen dhe krijimin e projekt-vendimeve të shoqëruara me urdhërpagesat e përfituesve në zonat pilot.

Përdorimi i regjistrin të NE lejon kontrollin e kryqëzuar të informacionit mbi familjen dhe / ose individin me sistemet e informacionit të institucioneve të tjera që përmbajnë të dhëna tatimore, punësimin, automjeteve, gjendjes civile, apo regjistrimi të bizneseve. Kjo jo vetëm përshpejton dhe ul kostot e procesit e kontrollit të situatës ekonomike të aplikuesve, por ul dhe mundësinë e abuzimit me skemën e Ndihmës Ekonomike.

Familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet në rrezik do të jenë përfituesit kryesorë të reformave të mbështetura nga PMAS. Në mënyrë të veçantë, mbështeten përpjekjet për të përdorimin me efektivitet të burimeve për më të varfrit dhe më të rrezikuarit në shoqëri, duke përfshirë në skemën e NE-së të varfrit që aktualisht janë përjashtuar.

PMAS mbështet gjithashtu përmirësimet dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve, në procesin e aplikimit dhe ndërveprimin aplikues – administrator shoqëror, si dhe në raportimin dhe informimin në kohë reale të institucioneve përgjegjëse, për tregues të caktuar që shërbejnë në procesin e vendim-marrjes dhe zhvillimit të politikave. PMAS është duke u pilotuar në tri zona (rajonet Tiranë, Elbasan dhe Durrës).

Rezultatet e para të pilotimit tregojnë se sistemi i ri i përzgjedhjes në përgjithësi shenjëstron familjet më të varfra. Familjet përfituese kanë qenë përgjithësisht ato më të mëdha, me më shumë fëmijë, me ndjekje të shkollës më të ulët, me kushte më të këqija strehimi dhe me shpenzime familjare më të ulëta sesa ato të përjashtuara nga skema e re<sup>2</sup>. Ky studim fillestar do të vazhdojë deri në fund të vitit 2015 për të identifikuar ndikimin e skemës së reformuar. MMSR-ja, gjatë zbatimit të pilotimit, do të analizojë edhe çështje të tjera në nivele të ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore (procese të brendshme dhe çështje administrative) për të garantuar shtrirjen me sukses të skemës së reformuar në nivel kombëtar.

Aktualisht ka disa lidhje mes skemës së NE-së dhe politikave aktive të punësimin. Këto të fundit janë të kufizuara në Shqipëri dhe rrjedhimisht kanë ndikim të kufizuar. Në këtë kontekst, duke parë edhe natyrën informale të tregut të punës në Shqipëri dhe kapacitetin e kufizuar të shërbimeve publike (dhe duke parë nivelin shumë të ulët të pagesës së NE-së),

<sup>1</sup> Pika 1, neni 10, ligj nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar

<sup>2</sup>T. Jantzi, *Initial Baseline Report: Albanian Ndihma Ekonomike – Social Assistance Modernization Project*, 2014.

nuk do të ishte realiste që të propozohet një politikë më e gjerë e politikave aktive të punësimit të njëjtë me atë të vendeve më të zhvilluara të BE-së.

Të gjithë aplikantët e NE-së duhet të regjistrohen çdo muaj si të punëkërkuar të papunë. Kjo praktikë duket se ka sjellë rezultate të kufizuara dhe ka imponuar një barrë administrative në zyrat e punësimit. Punëkërkuar të papunë përfitues të Ndhmës Ekonomike ishin 68,177 persona në nivel kombëtar për tremujorin e parë të 2015, kryesisht me nivel arsimor të ulët. Edhe pse 54% e ofertave për punësim ishin për profesione elementare, zanatçinj dhe shërbime të përgjithshme, vetëm 5,8% e punësimeve (gati 1000 persona) ishin përfitues të Ndhmës Ekonomike.<sup>1</sup> Një aspekt tjetër është dhe mbulimi i ulët i zonave rurale nga zyrat e punësimit.

Bazuar në programin e Qeverisë Shqiptare skema e NE-së do të reformohet dhe transformohet me Programin e Riintegritit Social. Kjo do të reflektojë shenjëstrimin më të mirë dhe një fokus më të gjerë në punësim dhe një qasje më aktive:

*Do të zhvillohet një paketë rregullatore që synon transformimin e Programit të Ndhmës Ekonomike në Programin e Riintegritit Social. Përfshirja e përfituesve të Ndhmës Ekonomike në politikën zhvillimore të territorit, si zhvillimi rural, zhvillimi infrastrukturës, apo shfrytëzimi i pyjeve dhe kullotave do të analizohen në kuadër të krijimit të vendeve të punëve në territor, të cilat në shumë raste kërkojnë aftësi elementare, apo kualifikime afatshkurtra.*

Forma të organizimit të veprimtarive ekonomike si biznesi social, ndërmarrja sociale, të cilat mund të ndikojnë ndërmjet të tjerash edhe në rritjen e shanseve për përfshirje dhe integrim në punësim të punëkërkuarve të papunë përfitues të NE, nuk janë rregulluar ende në legjislacion.

Ekzistojnë disa lidhje formale mes skemës së NE-së dhe shërbimeve të tjera, siç është qasja ndaj arsimimit dhe kujdesit shëndetësor dhe ka hapësirë për konsolidimin e një pakete të plotë shërbimesh ndaj përfituesve të Ndhmës Ekonomike.

**1.1. Sfidat lidhur me skemën e Ndhmës Ekonomike.** Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me rritjen e efikasitetit të skemës së ndihmës ekonomike duke e kthyer nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të riintegritit dhe alternimit të tyre me skemat e punësimit.

Pas zbatimit të pilotimit të PMAS dhe në bazë të rezultateve të monitorimeve dhe analizave që janë duke u zhvilluar, MMSR do të vendosë për hapat që do të ndërmerren për shtrirjen e skemës së re në nivel kombëtar në 2016. Shtrirja në nivel kombëtar do të kërkojë ndryshime në legjislacionin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Sfidë mbeten edhe shtrirja e proceseve të aplikimeve dhe përzgjedhjes së përfituesve nëpërmjet regjistrimit kombëtar dhe formulës së pikëzuar, gjë që do të kërkojë monitorim, raportim dhe përmirësimet e nevojshme të proceseve të punës dhe procedurave, ashtu si dhe përshtatjes sipas karakteristikave të territorit ku do të zbatohen, për të rritur shenjëstrimin dhe mbulimin e individëve dhe familjeve më të varfra.

Ndër çështjet që duhen adresuar janë rritja e shenjëstrimit të familjeve të varfra dhe ekstremisht të varfra, rritja e mbulimit të tyre nga skema dhe ulja në mënyrë drastike e numrit të përfituesve jo-të varfër.

---

<sup>1</sup> Buletini i Tregut të Punës 2014, Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Sfidë do të jetë integrimi me sistemet e informacionit të institucioneve të tjera në nivel kombëtar dhe shtrirja e automatizimit të proceseve deri në pagesën e drejtpërdrejtë të përfituesve nëpërmjet Thesarit të Shtetit, gjë që kërkon edhe integrimin me sistemin elektronik të këtij institucioni. Duhet të sigurohen aftësitë e nevojshme të personelit përgjegjës në të gjitha nivelet. Zbatimi i skemës së reformuar në nivel kombëtar kërkon një sensibilizim dhe ndërgjegjësim të opinionit publik dhe grupeve të interesit, për të komunikuar në mënyrë të shenjëstruar se kush janë qëllimet reale dhe rezultatet e pritshme të reformës.

Duhet rritur efikasiteti i proceseve të regjistrimit të punëkërkuësve të papunë, për të reduktuar barrën administrative, ndërkohë që duhet të rritur treguesit e ndërmjetësimit për punë të përfituesve të Ndhmës Ekonomike. Duhet siguruar një kontroll dhe audit i vazhdueshëm i zbatimit dhe ndikimit të masave. Këto masa do të përfshihen në Planin e Veprimit që do të zhvillohet sipas kësaj Strategjie.

Në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse, përfituesit e Ndhmës Ekonomike duhet të përfshihen në politikat zhvillimore të territorit, si zhvillimi rural, zhvillimi infrastrukturës, apo shfrytëzimi i pyjeve dhe kullotave.

Ndërmarrjet sociale do të rregullohen me ligj të veçantë por sfidë mbetet nxitja reale e këtij modeli, ashtu siç është sfidë edhe orientimi i përgjegjësisë sociale në financimin e aktiviteteve që synojnë integrimin në punë të kësaj pjese të popullsisë.

Duhet rritur ndërlidhjet e shërbimeve ndaj përfituesve të Ndhmës Ekonomike, në shëndetësi, arsim, strehim, apo tjetër dhe duhet synuar konsolidimi i një pakete të plotë shërbimesh ndaj përfituesve të Ndhmës Ekonomike.

**2. Aftësia e kufizuar.** "Pagesa e Aftësisë së Kufizuar" (PAK) është pjesë e programit të Mbrojtjes Sociale dhe shërben për të mbështetur njerëzit me aftësi të kufizuara dhe përmirësuar cilësinë e jetesës. Aktualisht PAK është mekanizmi i vetëm për mbështetjen e tyre, pasi vlerësohen për nivelin e aftësisë së kufizuar nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP).

Shpenzimet për pagesat e aftësisë së kufizuar janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit dhe tashmë përbëjnë pjesën kryesore në shpenzimet e Mbrojtjes Sociale. Kjo është shkaktuar nga indeksimi i lartë i përfitimit dhe mbulimi i zgjeruar.

Masa e pagesës për aftësinë e kufizuar është shumë më e lartë se masa e NE-së. Për shembull, shumica e pagesës për aftësinë e kufizuar për një person me aftësi të kufizuara fizike ose mendore është 9900 lekë në muaj (në krahasim me një pagesë mesatare familjare të vetëm 3,800 Lekë si NE).

Në përgjithësi, shpenzimet për aftësinë e kufizuar janë rritur ndjeshëm në vlerë absolute gjatë dekadës së fundit dhe, ndryshe nga NE, është rritur edhe si përqindje e PBB-së (shih figurën 2). Po kështu numri i personave që marrin pagesën e aftësisë së kufizuar është rritur me gati dy të tretat (63.7%) në mbi 160.000.

Edhe pse kjo skemë nuk ka qartësisht objekt shtresat e varfra, në praktikë kuintili më i varfër i popullsisë merr 39% të shpenzimeve për aftësinë e kufizuar. Megjithatë, si në shumë vende në tranzicion, ekzistojnë disa çështje serioze në lidhje me funksionimin e skemës së aftësisë së kufizuar. Sistemi i vlerësimit është i bazuar thjesht në analiza mjekësore dhe nuk pasqyron

domosdoshmërisht peshën e aftësisë së kufizuar apo dëmtimit funksional bazuar në standardet e Klasifikimit Ndërkombëtar Funksional dhe Shëndetësor (ICF)<sup>1</sup>.

Një studim përfaqësues në nivel kombëtar (2011)<sup>2</sup> sugjeroi që 14%<sup>3</sup> e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar nuk kanë aftësi të kufizuar dhe 15% vetëm një aftësi të kufizuar të butë.

Qeveria Shqiptare është duke ndërmarrë një reformë të skemës PAK (përsëri mbështetur nga Banka Botërore<sup>4</sup>), e cila synon të shenjëstrojë pagesat e aftësisë së kufizuar tek ata me aftësi të kufizuara më të rënda, pra më në nevojë për mbështetje, duke krijuar një model më “social” të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Është e qartë se, për momentin, ka një numër të konsiderueshëm përfituesish të PAK, të cilët nuk kanë të drejtë të përfitojnë as në bazë të rregullave aktuale, p.sh. për shkak të diagnozës së pasaktë, ose për shkak se ata duhet të jenë përfitues të skemës së sigurimeve shoqërore (invaliditeti). Këta të fundit vazhdojnë të marrin pagesa në masë më të madhe, pasi përfitojnë nga të dyja skemat e pagesave, nga ajo e mbrojtjes dhe nga ajo e sigurisë sociale.

MMSR dhe Shërbimet Sociale Shtetërore (SHSSH) janë duke bërë një monitorim të detajuar dhe analizë të pagesave të aftësisë së kufizuar. Si pasojë ka pasur një reduktim të numrit të pagesave për aftësinë e kufizuar nga 161,000 në fillim të vitit 2013 në 149,000 në fund të 2014 (-7%). Ky proces do të vazhdojë përgjatë kohëzgjatjes së kësaj strategjie dhe MMSR do të sigurojë burime e nevojshme për SHSSH, në mënyrë që të lejojë vazhdimësinë.

Në parim, personave të cilëve u është refuzuar pagesa e aftësisë së kufizuar, pasi të konsideruara të lehta, duhet të këshillohen në lidhje me mundësitë e punësimit, por, në praktikë, ka pak ri-integrim të personave të tyre.

Niveli i pagesës për aftësinë e kufizuar është relativisht i lartë (të paktën në krahasim me NE). Megjithatë, struktura e përfitimeve është shumë e komplikuar dhe paraqet pagesa të dyfishta dhe të trefishta të personave që ndjekin shkollën dhe universitetin. Ky strukturim i pagesës në rastet e ndjekjes së shkollës mund të justifikohet si pagesë e kushtëzuar, por gjithsesi vlen të analizohet në të ardhmen.

Për sa i përket strukturimit të pagesave, më konkretisht pagesat në zëvendësim të shërbimeve të caktuara, apo ato për të zëvendësuar kostot që vinë si rrjedhojë e aftësive të kufizuara, duhet analizuar fakti se në përgjithësi, qëllimi kryesor i pagesave së aftësisë së kufizuar duhet të jetë zëvendësimi i të ardhurave dhe prandaj ato duhet të jenë standarde. Ndërsa për personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për shërbime shtesë, këto nuk duhet të jepen në formën e pagesave, por në formën e shërbimeve, pasi në të kundërt këto pagesa shtesë mund të mos përdoren për shërbime ndaj personit.

---

<sup>1</sup> International Classification of Functioning and Health, Klasifikimi Ndërkombëtar Funksional dhe Shëndetësor miratuar në Asamblenë Botërore të Shëndetit të 54, 22 Maj 2001

<sup>2</sup> World Bank survey under PSIA project 2011

<sup>3</sup> Treguesi specifik është marrë si tregues performance nga projekti PMAS i BB nga simulimet e ndërtaura në dokumentin Social Assistance Modernization Project, lidhur reformimin e PAK

<sup>4</sup> Ligj nr. 84/2012, datë 18 shtator 2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale”

**2.1. Sfidat lidhur për aftësinë e kufizuar.** Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me vlerësimin e kriterëve të aftësisë së kufizuar, rishikimin e masës së pagesave të aftësisë së kufizuar në përputhje me standardet bashkohore evropiane dhe ri-integrimin e PAK me shërbimet sociale dhe shëndetësore.

Zbatimi i reformës së skemës së aftësisë së kufizuar sipas marrëveshjes me Bankë Botërore<sup>1</sup>, parashtron disa sfida të lidhura me:

- rishikimin e kriterëve për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar, bazuar në një model bio-psiko-social, të ndërtuar në standarde bashkohore dhe në modelin konceptual të ICF-së nga Organizata Botërore e Shëndetësisë;
- krijimin e një procesi të ri për përcaktimin e aftësisë së kufizuar, duke rimodeluar proceset e punës dhe procedurat, si dhe duke përdorur teknologjinë e informacionit, me qëllim krijimin e një sistemi të menaxhimit të informacionit. Procedurat dhe proceset duhet të automatizohen në masën më të madhe të mundshme dhe duhet të synohet një proces i drejtë dhe transparent, ashtu siç duhet të mundësohet ulja e rasteve të abuzimeve;
- reformën në administrimin e vlerësimit dhe përcaktimit të aftësisë së kufizuar, për sa i përket strukturave të komisioneve të vlerësimit të strukturuar në territor dhe në varësi të SHSSH, ashtu si dhe strukturave dhe proceseve të punës të nevojshme për planifikimin, organizimin, administrimin dhe kontrollin e procesit të vlerësimit.

Duhet adresuar çështja e mbivendosjes së përfitimeve nga skemat e mbrojtjes dhe sigurisë sociale. MMSR do të sigurojë koordinim më të mirë me ISSH-në për të siguruar që kjo nuk do të ndodhë në të ardhmen. Hapi i parë do të jetë ngritja e një grupi pune për identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve të mbivendosjes së përfitimeve ndërmjet SHSSH-së dhe ISSH-së.

MMSR do të krijojë një dialog të vazhdueshëm ndërmjet zyrave përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe atyre për shërbimet e punësimit, për rritjen e hapësirave për ri-integrimin në punë të personave me aftësi të kufizuar. Masat specifike do të përfshihen në Planin e Veprimit.

Bazuar në nevojat reale të personave me aftësi të kufizuar, vlerësimit bio-psiko-social të gjendjes së tyre, sfida mbetet strukturimi më i përshtatshëm i pagesave të aftësisë së kufizuar, ashtu si dhe integrimi i tyre me shërbimet shoqërore, për synuar plotësimin në masën më të madhe nevojat e tyre.

**3. Shërbimet e Kujdesit Shoqëror.** Shërbimet e Kujdesit Shoqëror janë pjesë e Programit të Mbrojtjes Sociale, të financuara nga buxheti i shtetit. Aktualisht ka mangësi në mbulimin e të gjithë nevojave për shërbime të grupeve vulnerabel në nivel kombëtar.

Shërbimet të kujdesit shoqëror të specializuara janë siguruar nga organizatat jo-fitimprurëse e financuara në baza vullnetare ose nga partnerët. Shërbimet mund të gjenden kryesisht në zonat e mëdha urbane (90% janë në zonat urbane) dhe 75% e tyre përqendrohen në zonat perëndimore dhe qendrore të vendit<sup>2</sup>. Ndryshe nga skemat e pagesave të NE dhe PAK, sfida këtu është ngritja e një sistemi shërbimesh të përkujdesit shoqëror që të mund mbulojë më gjërë nevojat e grupeve në nevojë për shërbime shoqërore të integruara dhe efikase.

---

<sup>1</sup> Ligj nr. 84/2012, datë 18 shtator 2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale”

<sup>2</sup> UNICEF, studim në krijimin e hartës së shërbimeve të kujdesit social.

Shërbimet e kujdesit social përbëjnë një përqindje të vogël (më pak se 5%) të shpenzimeve totale të MMSR për mbrojtjen sociale (Fig. 3), ku pjesën më të madhe të shpenzimeve vjetore e zënë Ndihma Ekonomike dhe PAK<sup>1</sup>. Edhe pse shpenzimet e MMSR-së për kujdesin shoqëror janë gati dyfishuar nga viti 2005, nuk ka pasur rritje të shpenzimeve të tyre në krahasim me shpenzimet në total, por një ulje gjatë dekadës së fundit..

Fig. 3: Shpenzimet për Mbrojtjen Sociale të MMSR të ndara sipas politikave



Shërbimet institucionale formojnë një pjesë të rëndësishme të shërbimeve të kujdesit social. Në krahasim me shumë vende të tjera në tranzicion, Shqipëria ka nivele mjaft të ulëta të institucionalizimit. Një studim i fundit, i mbështetur nga UNICEF, shqyrtoi institucionet publike dhe private të kujdesit për fëmijët, 24 institucione rezidenciale për fëmijët dhe të tetë Qendrave të Zhvillimit në vend<sup>2</sup>. Studimi zbuloi se në periudhën janar-maj 2014, 989 fëmijëve u është siguruar strehim (835 fëmijët pa aftësi të kufizuara në institucionet rezidenciale dhe 154 fëmijë me aftësi të kufizuara në Qendrat e Zhvillimit).

Më shumë se 37%, (320), e totalit të fëmijëve të vendosur në institucione rezidenciale ishin nën moshën 3 vjeç në kohën kur u pranuan. Modeli i pranimit të fëmijëve të vegjël në institucionet, që kalojnë më pas në kujdesin institucional afatgjatë, duket relativisht i qëndrueshëm.

Përqindja e fëmijëve të regjistruar si të pranuar në institucion për arsye të varfërisë së familjes ishte pothuajse dy herë më shumë se sa i atyre të regjistruar si të 'braktisur'. 32 fëmijë janë regjistruar si jetimë në kohën e pranimit. Përvoja ndërkombëtare është se zakonisht ka arsye të shumta pse një fëmijë vendoset në një institucion.

Në kuadër të reformave në sistemin e shërbimeve shoqërore janë ndërmarrë një sërë masash për garantimin e një rrjeti të qëndrueshëm e cilësor të shërbimeve të decentralizuara të perkujdesit në varësi të njësisive të qeverisjes vendore. Janë mbështetur me fonde dhe ekspertizë 23 shërbime rezidenciale të perkujdesit shoqëror, 15 shërbime të perkujdesit

<sup>1</sup>Autoritetet lokale shpenzojnë një sasi shtesë të shërbimeve të kujdesit shoqëror, edhe pse një shifër totale kombëtare nuk ka qenë në dispozicion. Përveç kësaj, OJQ-të gjithashtu ofrojnë një gamë të shërbimeve shpesh të financuara nga partnerët e zhvillimit. Përsëri një vlerësim të shpenzimeve në nivel kombëtar nuk është në dispozicion.

<sup>2</sup>P. Evans and NGO Future Centre, *A survey of children resident in public and non-public institutions in Albania*, UNICEF, 2014.

shoqëror rezidenciale për grupet në nevojë (fëmijë, PAK të moshuar, viktimat trafikingu) të decentralizuara dhe 8 shërbime rezidenciale të përkujdesit shoqëror kombëtare. Qëllimi ka qenë mbulimi nevojave të individëve atje ku nuk janë të ngritura shërbimet e përkujdesit social rezidenciale. Gjithashtu janë decentralizuar edhe 4 shërbime të përkujdesit shoqëror ditor për grupet në nevojë.

Janë ngritur 2 shërbime rezidenciale të përkujdesit shoqëror kombëtar për viktimat e dhunës në familje si dhe shërbimi polivalente për kategoritë në nevojë. Gjatë viteve 2007-2012 janë nxitur dhe mbështetur financiarisht iniciativat e njësisve të qeverisjes vendore për ngritjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror ditor dhe “shtëpi familje” në Kukës, Kuçovë, Elbasan Berat dhe Shkodër për grupet në nevojë (të moshuar, PAK). Janë transferuar shërbimet rezidenciale të përkujdesit shoqëror sipas modelit të shërbimeve “shtëpi-familje” për fëmijët në Tiranë dhe në Shkodër (Shtëpitë e Fëmijës Shkollor), përveç modelit të ngritur në Durrës në vitin 2004.

Gjithashtu reforma është drejtuar edhe në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e standardeve të shërbimit shoqëror si dhe rritjen e bashkëpunimit të shoqërisë civile dhe operatorëve privatë.

Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të ligjit 9355 “Për ndihmën dhe shërbimeve shoqërore” (i ndryshuar) mundësuan ngritjen e Inspektoratit të Pagesave në *Cash* dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror pranë SHSSH. Me zbatimin e Reformës në Inspektim dhe legjislacionit përkatës për inspektimin në Republikën e Shqipërisë u krijua në vijim të Inspektoratit Punës dhe Shërbimeve Sociale. Si rrjedhojë kjo solli ndarjen e Inspektoriatit të Pagesave në *Cash* nga Inspektoratit i Shërbimeve Sociale. Në kuadër të këtyre ndryshimeve u përmirësua dhe statusi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror ku brenda kësaj strukture funksionon Drejtoria e Kontrollit të Pagesave në *Cash*.

Forcimi i instrumenteve të monitorimit dhe inspektimit të shërbimeve të ofruara në institucionet e përkujdesit shoqëror publik dhe jo-publik nga Shërbimi Social Shtetëror, gjatë vitit 2013, ka përmirësuar kushtet dhe jetesën në këto qendra rezidenciale dhe ditore, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në fuqizimin e kapaciteteve të stafeve që ofrojnë shërbime.

Zbatimi i standardeve të përkujdesit shoqëror për fëmijë, PAK dhe të moshuar, viktimave të trafikimit, viktimave të dhunës në familje nga subjektet publike dhe jo-publike të përkujdesit shoqëror për kategoritë në nevojë, ka rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve për këto kategori dhe ka realizuar tipologji të reja të përmendura sa më lartë.

Me përmirësimin e kuadrit ligjor për licencimin e OJF-ve, janë lehtësuar procedurat e ofruesve të shërbimeve që kërkojnë të marrin licencë dhe është rritur transparenca ndërmjet shoqërisë civile dhe organeve shtetërore. Ky legjislacion i ndryshuar solli krijimin e Qendrës Kombëtare të Licencimit si institucion i drejtpërdrejtë i dhënies së licencës.

Subjektet publike dhe jopublike të licencuara që ofrojnë shërbime shoqërore, pavarësisht llojit të shërbimeve, brenda standardeve të shërbimeve sociale, u rritën me 56% në numër krahasuar me vitin 2007. Në vitin 2007 numri i subjekteve publike dhe jo-publike që ofronin shërbime të përkujdesit social ka qenë 120 subjekte ndërsa në vitin 2011 numri i subjekteve publike dhe jo-publike që ofronin shërbime të përkujdesit social arriti në 187 subjekte.

Aktualisht shërbimet e kujdesit social jo-institucional janë shumë të kufizuara dhe sektori

shitetëror nuk ka ekspertizën ose kapacitetin e nevojshëm për t'i siguruar në shkallë të gjërë. Shërbimet ekzistuese ofrohen kryesisht nga organizatat jo-fitimprurëse dhe ofruesit e tjerë jo-publikë.

Shqipëria ka një numër relativisht të ulët të personave në shërbimet institucionale, në krahasim me vendet e tjera në tranzicion dhe ka nevojë për rritje të cilësisë, referuar nevojave të personave përfitues të këtyre shërbimeve.

**3.1. Sfidat e lidhura me shërbimet e kujdesit shoqëror.** Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me krijimin e një sistemi funksional dhe efektiv të kujdesit shoqëror të bazuar në parimin e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabel në programet e mbrojtjes sociale.

Për këtë gjë nevojitet të strukturohet një rrjet në territor dhe të përcaktohen paketat e shërbimeve dhe integrimi i tyre, ashtu si dhe masat e financimit të nevojshëm. Financimi i shërbimeve mbetet një tjetër çështje që duhet adresuar, pasi aktualisht zënë një pjesë të vogël të shpenzimeve të programit të mbrojtjes sociale.

Shërbimet e përkujdesit shoqëror duhet të shenjëstrojnë kategoritë më të rrezikuara, duke synuar mbulimin e tyre me shërbime dhe në varësi të mundësisë së financimit, të vazhdojë mbulimin progresiv të popullsisë.

Sfidë mbetet administrimi i procesit të licencimit dhe kontrollit/inspektimit të institucioneve të përkujdesit shëndetësor. Këto procese dhe procedura punë duhet të sigurojnë cilësi dhe standarde të shërbimeve. Edhe vetë standardet janë objekt përmirësimi i vazhdueshëm. Përtej strukturimit të proceseve të punës, ashtu si dhe vetë strukturave përgjegjëse, sfidë mbetet rritja e kapaciteteve të personelit, përfshirë këtu edhe ato që japin shërbimet.

Qasjet e reja siç është qasja e *ciklit të jetës* kërkojnë fuqizim të aktiviteteve të planifikimit, organizimit, administrimit dhe kontrollit të shërbimeve të përkujdesit në të gjitha nivelet.

Modelet e shpërndarjes dhe strukturimit të rrjetit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror janë të shumta dhe ndërvarësitë e tyre nga qeverisja vendore dhe qendrore mund të jenë të ndryshme. Për këtë arsye, sfidë mbetet analiza dhe gjetja e modelit më të përshtatshëm të decentralizimit të shërbimeve, e harmonizuar kjo me reformën territoriale që po zbatohet në vend.

Qeveria shqiptare mbështet ofrimin e kujdesit social në komunitet në masën më të madhe të mundshme dhe një reduktim në kujdesin institucional. Deinstitutionalizimi mbetet një sfidë, pasi kërkon krijimin e një rrjeti shërbimesh në territor, strukturim të proceseve dhe procedurave për menaxhimin e rasteve dhe rritje kapacitetesh të profesionistëve.

Një çështje tjetër që paraqet sfidë është prania e hapësirave të pambuluara me shërbime nga institucionet publike dhe që mund të mbulohen nga institucionet private apo të sektorit të tretë. Kështu në rastet kur mungojnë shërbimet nga institucionet publike shërbimet duhet të kontraktohen nga organizatat jo-fitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve. Kjo do të zvogëlonte kostot e ngritjes (set-up) (dhe kohën) dhe të lejonte fleksibilitet më të madh në ofrimin e shërbimit (p.sh. vetëm shteti do të ishte i kufizuar në ofrimin e llojeve të veçanta të shërbimeve). Prandaj duhet të merren masa për të analizuar më mirë llojet e aktiviteteve dhe kostimi i tyre për të gjitha institucionet në bazë të tipologjisë së shërbimeve.

Të dhënat e shërbimeve të përkujdesit shoqëror mund të integroheshin në një sistem të



menaxhimit të informacionit, duke lehtësuar edhe shkëmbimin e të dhënave me shërbime të tjera, por edhe duke rritur cilësinë e aktiviteteve, nga planifikimi deri tek kontrolli.

## II. VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 është e ndërtuar mbi parimet që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa për të Drejtën e personave me Aftësi të Kufizuara, Karta Sociale Evropiane e rishikuar, Karta Evropiane e Autonomisë Lokale, Komunikata e Komisionit Evropian datë 12 Mars 1997 “Mbi modernizimin dhe përmirësimin e Mbrojtjes Shoqërore”, Strategjinë Evropiane deri në 2020.

E drejta për mbrojtjen sociale është reflektuar në Kushtetutën e Shqipërisë<sup>1</sup>. Neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore njeh të drejtën e secilit për të pasur mbrojtje sociale. Në mënyrë të ngjashme, në Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara njihin gjithashtu të drejtat e veçanta për mbrojtjen sociale<sup>2</sup>. Zbatimi i suksesshëm i kësaj strategjie do të kontribuojë në përforcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri. Parimet janë|:

*Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi:* Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.

*Mbrojtja:* Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.

*E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit:* Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.

*Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve:* Individët janë përgjegjës për jetën e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.

*Përfshirja dhe integrimi.*

*Respektimi i të drejtave dhe nevojave.*

*Partneriteti:* koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.

*Cilësia e shërbimeve.*

*Standardet Kombëtare udhëheqin vendimmarrjen në nivel vendor.*

Strategjia ka gjithashtu, synimin të shërbejë si bazë për dialog të mëtejshëm të strukturuar me Bashkimin Evropian (BE), agjencitë ndërkombëtare dhe partnerët socialë mbi çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes sociale. Një qëllim i rëndësishëm është përputhja me Agjendën Sociale të BE 2020, duke ndihmuar vendin në arritjen e synimeve të saj për integrimin në BE.

Programet Parandaluese dhe të Riintegritimit Social të alternuar me skemat e punësimit do të konvergojnë me konceptet të cilat po përshtaten aktualisht nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Ne vitin 2020 mirëqenia e përgjithshme e popullsisë do të jetë përmirësuar,

<sup>1</sup>Neni 52.2. thekson se “Çdo person që për arsye të mos dëshirës së tij/saj humbet punën dhe nuk ka mjete të tjera mbështetjeje, ka të drejtën për ndihmë sociale, sipas kushteve që parashikon ligji”

<sup>2</sup>Nenet 26 dhe 28 respektivisht

varfëria dhe përjashtimi social do të jenë zbutur, nëpërmjet realizimit të qëllimeve dhe objektivave strategjike të shtjelluara në këtë strategji ndërsektoriale.

## 1. Vizioni

*Ndërtimi i një sistemi mbrojtjeje sociale që të luftojë pabarazitë social-ekonomike, parashikimi i një sistemi që ka politikën dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë, ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegrit social alternuar me skemat e punësimit.*

## 2. Politikën

Strategjia e Mbrojtjes Sociale bazohet në politikën për:

A. *Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë*, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, përmirësimin e shenjëstrimit të tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndhmës Ekonomike, si dhe lidhjen me shërbime të integruara dhe skemat e punësimit, me qëllim riintegrit social të tyre.

B. *Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara*, nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në Cash me shërbime të integruara, me qëllim integritin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

C. *Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social*, bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri.

Bazuar në këto politika strategjia kërkon të ndërtojë pavarësinë dhe autonominë e individëve, duke mundësuar mbështetje më të mirë dhe më të përshtatshme për personat dhe familjet e prekura nga varfëria.

## 3. Qëllimet strategjike

Strategji Sektoriale e mbrojtjes Sociale identifikon qëllimet dhe objektivat e mëposhtme për realizimin e politikave:

**A Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë**, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, duke përmirësuar shenjëstrimin e tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndhmës Ekonomike, lidhjen me skemat e punësimit, me qëllim riintegrit social të tyre.

Deri në vitin 2020, të ndikohet në zbutjen e varfërisë ekstreme duke rritur shenjëstrimin e individëve dhe familjeve ekstremisht të varfra, ashtu si dhe riintegritin social të tyre duke rritur në 10% pjesën e përfituesve të përfshirë në skemat e punësimit, duke e kthyer nga një skemë pasive në një skemë aktive. Qëllimet e kësaj politike sektoriale do të synohen të realizohen nëpërmjet përbushjes së këtyre objektivave:

A1. Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës të Ndhmës Ekonomike nëpërmjet targetimit më të mirë të familjeve të varfëra.

A2. Modernizimi skemës së Ndhmës Ekonomike me anë të administrimit të regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit, duke arritur që 95%<sup>1</sup> përfituesve të jenë përzgjedhur nëpërmjet këtyre instrumenteve deri në vitin 2017.

A3. Rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndhmës Ekonomike.

A4. Përmirësimi i shërbimeve të kontrollit/auditit për të reduktuar numrin e abuzimeve.

A5. Transformimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë aktive riintegrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim, duke rritur përfshirjen në politikat aktive të tregut të punës në 5% të përfituesve të Ndhmës Ekonomike deri në 2017.

**B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara**, nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurr skemën e pagesave në *Cash* me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Qëllimi është që deri në vitin 2020, çdo fëmijë, apo/dhe i rritur me aftësi të kufizuara të ketë akses dhe përfitojë nga shërbimet e nevojshme sociale dhe të integruara nëpërmjet skemave të Programit të Mbrojtjes Sociale. Nevojat e personave me aftësi të kufizuar, do të vlerësohen duke synuar standardet më të mira ndërkombëtare, sipas modelit bio-psiko-social që do të përdoret duke rritur 4,5% numrin e përfituesve dhe duke ulur në 10% numrin e rasteve abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar. Qëllimet e kësaj politike sektoriale do të synohen të realizohen nëpërmjet përbushjes së këtyre objektivave:

B1. Reformimi i sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar deri në 2017, duke vënë në zbatim sistemin e ri të vlerësimit sipas “Modelit Social”<sup>2</sup> dhe duke ulur përqindjen e rasteve abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar në 10%.

B2. Rritja e transparencës së skemës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet ngritjes së regjistrit elektronik PAK, duke e vënë në funksion këtë regjistrë në 90% të njësive të qeverisjes vendore në rajonet e përzgjedhura deri në 2017.

B3. Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në *Cash*, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuar deri në 2020.

B4. Ngritja dhe forcimi i mekanizmit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve PAK në nivel vendor dhe qendror, duke garantuar deri në 2017 gjenerimin e raporteve tremujore të performancës së skemës për politik-bërësit dhe për vlerësimin e profilit të riskut dhe zbulimin e abuzimeve.

**C. Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social**, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale.

Deri në vitin 2020, çdo fëmijë, apo/dhe i rritur, si dhe familje shqiptare të kenë akses të barabartë dhe të përfitojnë nga një sistem funksional dhe gjithëpërfshirës të shërbimeve të

<sup>1</sup> Si referenca 1 e kësaj faqeje

<sup>2</sup> Banka Botërore, treguesit janë marrë nga simulimet e ndërtuara në dokumentin Social Assistance Modernization Project.

përkujdesit shoqëror. Bazuar në parimin e decentralizimit, deinstitutionalizimit synohet rritja me mbi 10% e numrit të përfituesve të shërbimeve komunitare dhe shërbimeve alternative sociale, duke rishikuar dhe adoptuar 434 shërbime (2015-2020). Qëllimet e kësaj politike sektoriale do të synohen të realizohen nëpërmjet përmbushjes së objektivave të mëposhtëme:

C1. Ngritja e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore në zonat e përzgjedhura deri në 2017 dhe në nivel kombëtar deri në 2020;

C2. Rishikimi i funksioneve të planifikimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për nivele të ndryshme të qeverisjes vendore dhe modele të reja në zbatim deri në 2017.

C3. Ngritja e Sistemit të integruar të Informacionit në nivel rajonal dhe qendror, për të identifikuar, referuar nevojat për shërbime të përkujdesit shoqëror deri në 2018.

C4. Ngritja dhe fuqizimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve sociale në nivel lokal, rajonal dhe qendror deri në 2020.

C5. Profesionalizimi i forcës së punës dhe ofruesve të shërbimeve sociale nëpërmjet krijimit të një sistemi të kualifikimit deri në 2020.

C6. Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik për parandalimin e problemeve sociale dhe adresimin pranë shërbimeve sociale, nëpërmjet fushatave të komunikimit deri në 2018.

### **III. OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE PRODUKTET MADHORE**

Në këtë kapitull bëhet një renditje e objektivat kryesore të politikës së strategjisë së Mbrojtjes Sociale sipas qëllimeve strategjike.

#### **A. Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë**

Në përputhje me qëllimin e parë strategjik, zbutja e varfërisë është një prioritet kyç i Strategjisë së re. Skema reformuar e NE-së do të synojë të reduktojë varfërinë (sidomos varfërinë ekstreme), duke siguruar pagesa për ata që janë në nevojë dhe për aq sa të jetë e mundur, mbështetjen e njerëzve për të dalë nga varfëria duke siguruar terrenin për të gjetur mundësitë e riintegritit social dhe ekonomik. Kështu ajo do të synojë të sigurojë asistencë afat-shkurtër për personat në nevojë, ndërkohë që do t'i inkurajojë dhe mbështesë ata për daljen nga skema duke u punësuar etj., por edhe duke pranuar se një përqindje e aplikantëve do të kërkojnë mbështetje afat-gjatë.

Produkti për politikën zbutja e varfërisë është transformimi i skemës së Ndhmës Ekonomike, në mënyrë që të shenjëstrohen vetëm familjet e prekura nga varfëria dhe mbështetur ato më mirë, për t'u përballur me rreziqet duke hyrë në masat mbrojtëse sociale dhe mundësi më të mira jetese. Objektivat e kësaj politike janë si vijon:

**A1. Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës të Ndhmës Ekonomike**, si një nga mekanizmat për të zbutur varfërinë nëpërmjet përfshirjes sociale më të gjerë dhe shenjëstrimit më i mirë i familjeve në nevojë dhe me fokus fëmijët. Qëllimi i reformës, është rritja e shenjëstrimit dhe mbulimit të familjeve të varfra, krijimi i një sistemi të paanshëm dhe transparent, duke ulur subjektivitetin në vendim-marrje, si dhe rritja e efikasitetit në administrimin e skemës.

Brenda vitit 2017 do të synohet shtrirja e skemës së reformuar në nivel kombëtar me qëllim arritjen e treguesve të mëposhtëm për sa i përket shenjëstrimit dhe mbulimit të skemës.

Gjithashtu tregues të suksesit të këtij objekti do të jenë përdorimi i kritereve të reja të përfitimit në nivel kombëtar brenda kësaj periudhe, të cilat do të konsultohen, vendosen dhe zbatohen duke rritur transparencën e skemës.

Në kuadër të këtij objekti do të synohet edhe nxitja e arsimimit dhe vaksinimit të gjithë fëmijëve përfitues të programit të Ndhmës Ekonomike përmes masave nxitëse progresive. MMSR-ja do të punojë me qeveritë vendore dhe rajonale për të identifikuar masat praktike që do të ndihmojnë në mbështetjen e familjeve dhe individëve me Ndhmë Ekonomike, për shembull, duke i mbështetur në qasjen e tyre ndaj arsimimit dhe shërbimeve shëndetësore. Këto masa do të përfshihen në Planin e Veprimit që do të zhvillohet sipas kësaj Strategjie.

**A2. Modernizimi skemës së Ndhmës Ekonomike me anë të administrimit të regjistrimit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit, duke arritur që 95%<sup>1</sup> e përfituesve të jenë përzgjedhur sipas këtij sistemi deri në vitin 2017.** Të gjitha proceset dhe procedurat përkatëse do të realizohen nëpërmjet integrit të këtyre instrumenteve, nga aplikimi, përzgjedhja, vendim-marrja dhe deri tek pagesat nominale. Regjistri elektronik i Ndhmës Ekonomike do të zhvillohet më tej, duke mundësuar krijimin e profilit të riskut të përfituesve, për të zbuluar raste të mundshme abuzimi. Regjistri gjithashtu do të mundësojë monitorimin në kohë reale të skemës dhe do të vlerësojë performancën e saj. Pas fazës së pilotimit regjistri do të shtrihet në të gjithë territorin e vendit, duke shtrirë vendim-marrjen nëpërmjet formulës unike të pikëzimit në të gjithë vendin. Regjistri do të përfshijë module për menaxhimin e integruar dhe një lidhje me sistemin e Thesarit për të mundësuar pagesën e drejtpërdrejtë nëpërmjet thesarit të individëve dhe familjeve në nevojë. Regjistri do të mundësojë aksesin edhe institucioneve të tjera sipas rastit.

Modernizimi i skemës është i lidhur me objektivin A1 edhe me realizimin e treguesve lidhur me shenjëstrimin, mbulimin dhe transparencën.

**A3. Rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndhmës Ekonomike.** Do të synohet krijimi dhe forcimi i strukturave dhe mekanizmave monitorues, vlerësues dhe raportues në të gjitha nivelet.

Brenda vitit 2020 institucionet përgjegjëse të skemës së Ndhmës Ekonomike do të jenë të afta të për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e saj, ku një ndër aspektet kryesore do të jetë aftësi i personelit për instrumentet e reja të skemës së reformuar. Gjithashtu regjistri elektronik do të jetë i aftë për prodhimin e raporteve tremujore të performancës së skemës për politik-bërësit.

Kjo do të ndihmojë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimit të përdorimit të rritjes së kushtëzuar të NE-së, si për vaksinimin dhe ndjekjen e shkollës. Do të promovohen dhe monitoron në vazhdim masat dhe veprimet pozitive në njësitë vendore për rritjen e aksesit në arsim dhe shërbime shëndetësore.

Rritja e kapaciteteve është e lidhur me objektivin A1 dhe me realizimin e treguesve lidhur me shenjëstrimin, mbulimin dhe transparencën.

---

<sup>1</sup> Si referenca 1 e kësaj faqeje

**A4. Përmirësimi i shërbimeve të kontrollit/auditit për të reduktuar numrin e abuzimeve.** Do të synohet të përmirësohet cilësia e shërbimeve të kontrollit/auditit, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së ndërgjegjësimit të nëpunësve civil përgjegjës. Forcimi i kapaciteteve do të përqendrohet në mënyrë specifike, ndër të tjera, mbi menaxhimin e informacionit dhe mekanizmat e pagesës, në mënyrë që të kenë mundësi të zbulojnë rastet e abuzimit dhe gabimit apo penalitetet sipas rastit.

Përmirësimi i kontroll/auditit është e lidhur me objektivin A1 dhe me realizimin e treguesve lidhur me shenjëstrimin, mbulimin dhe transparencën.

**A5. Transformimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë aktive riintegrimi nëpërmjet krijimit të paketës për krijimin e mundësive për punësim, duke rritur përfshirjen në politikat aktive të tregut të punës në 5% të përfituesve të Ndhmës Ekonomike deri në 2017.** Rritja e efikasitetit të skemës së ndihmës ekonomike dhe kthimi nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të riintegritimit dhe alternimit të tyre me skemat e punësimit do të realizohet nëpërmjet disa hapave. Do të synohet krijimi i lidhjes së qëndrueshme midis skemës së Ndhmës ekonomike dhe skemave të arsimit profesional dhe programeve të përgatitjes për punësim me synim fuqizimin dhe aktivizimin e familjes dhe individit.

Fillimisht do të kryhet një studim për përfituesit e NE-së, në mënyrë që të vendoset se sa pranë janë aplikantët me tregun e punës dhe se si mund të ndërtohen mekanizmat për lidhjen me tregun e punës. Kjo do të hedhë vështrimin mbi aftësitë e personave që përfitojnë NE (ose që nuk kanë aftësi) krahasuar me aftësitë që kërkohen në tregun real të punës. Këto masa do të përfshihen në Planin e Veprimit që do të zhvillohet sipas kësaj Strategjie.

Në mënyrë që të trajtohen çështjet afatgjata të normës dhe strukturës së Programit të Riintegritimit Social (PRS), do të krijohet një grup pune për të shqyrtuar normën dhe strukturën e PRS-së që ka lidhje me koston dhe çështjet e tregut të punës. Ky grup do të studiojë mundësitë e ndryshme për përfitime, shpenzimet e përfshira, ndikimin e shpërndarjes dhe tregut të punës dhe të përcaktojë mundësitë për drejtimin e politikave afatgjatë. Mundësitë do të përfshijnë: mundësinë e futjes së një pagese me dy nivele, ku familjet më të varfra marrin pagesën më të lartë; dhe mundësinë e rritjes së elementeve të kushtëzuara të pagesës. Një proces i tillë do të përcaktojë mundësitë në kushtet e një strukture të përshtatshme përfitimesh dhe një normë të caktuar (ose varg normash) për pagesën e NE-së. Do të identifikojë kostot, ndikimet dhe implikimet e tjera të përfshira. Kjo do të ndihmojë Qeverinë Shqiptare për të marrë një vendim të informuar të politikave në nivelin e duhur të përfitimeve dhe një plan veprimi afatmesëm dhe afatgjatë.

## **B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara**

Deri më 2020, çdo fëmijë dhe /ose i rritur me aftësi të kufizuara në mënyrë progresive do të kenë qasje dhe do të përfitojnë nga pagesat dhe shërbimet sociale, të cilat janë të një cilësie më të lartë dhe të integruara përmes skemave të Programit të Mbrojtjes Sociale.

Qëllimi i krijimit të një procesi të ri për përcaktimin e aftësisë së kufizuar është (a) të zbatojë një metodologji bio-psiko-sociale për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar; (b) të krijojë një proces të përshtatshëm për çdo moshë; (c) të krijojë një proces transparent dhe të besueshëm dhe (d) të krijojë një proces me kosto efektive.

Propozimet më të hollësishme janë aktualisht duke u zhvilluar nga MMSR me mbështetjen e Bankës Botërore dhe është menduar që këto do të testohen më përpara në një numër të vogël të rasteve në zonat pilot, në fillim të vitit 2016. Kjo do të lejojë një vlerësim të ndikimit të mundshëm dhe vlerësim të kostove të këtij procesi.

**B1. Reformimi i sistemit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar deri në 2017, duke vënë në zbatim sistemin e ri të vlerësimit sipas “Modeli Social”<sup>1</sup> dhe duke ulur në 10% rastet abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar.**

Hartimi i kriterëve të reja për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar do të përfshijë përmirësimin dhe plotësimin e kriterëve ekzistues, për të (a) bërë të mundur vlerësimin biopsiko-social të aftësisë së kufizuar bazuar në modelin konceptual të ICF-së nga Organizata Botërore e Shëndetësisë; (b) të mundësuar një përshkrim më të detajuar të secilit kusht të aftësisë së kufizuar në mënyrë që të sigurojë uniformitetin dhe qëndrueshmëri në vlerësimin e aftësisë së kufizuar.

Në kuadër të këtij objekti do të synohet ngritja dhe fuqizimi i strukturave multidisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në nivel rajonal/qendror (fillimisht në format pilot). MMSR dhe SHSSH do të shqyrtojnë nëse ekziston nevoja për ndryshime të menjëhershme ligjore në strukturën e sistemit të vlerësimit, të tilla si transferimi i përgjegjësisë për menaxhimin e komisioneve të aftësisë së kufizuar në SHSSH, dhe çdo reformë procedurale në procesin aktual të aplikimit për ta bërë atë me kosto më efektive. Gjithashtu do të synohet rishikimi dhe ndryshimi i legjislacionit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

**B2. Rritja e transparencës së skemës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet ngritjes së regjistrit elektronik PAK, duke e vënë në funksion këtë regjistër në 90% të njësive të qeverisjes vendore në rajonet pilot deri në 2017<sup>2</sup>. Krijimi dhe zhvillimi i një Sistemi Menaxhimi Informacioni i integruar për skemën e pagesave të aftësisë së kufizuar duke përfshirë një regjistër elektronik kombëtar dhe një bazë të dhënash për çdo përfitues. Regjistri elektronik PAK është duke u zhvilluar aktualisht nga MMSR me mbështetjen e Bankës Botërore dhe kjo do të ndihmojë në zbatimin e një administrimi më efikas, eficient, efektiv dhe miqësor për përdoruesit dhe sidomos në drejtim të shërbimit ndaj aplikuesit për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar.**

**B3. Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në *Cash*, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuar deri në 2020. Ky objektivi është i lidhur me politikën C në vijim. Në parim, është e nevojshme të sigurohet që pagesat me para të jenë të integruara me ofrimin e shërbimeve të kujdesit social, për të garantuar që nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara të jenë përmbushur në mënyrë të plotë dhe të integruar. Administratorëve shoqërorë do të jenë pika e kontaktit për referimin e personave me aftësi të kufizuara për te agjencitë përgjegjëse.**

**B4. Ngritja dhe forcimi i mekanizmit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve PAK në nivel vendor dhe qendror, duke garantuar deri në 2017 gjenerimin e raporteve tremujore të performancës së skemës për politik-bërësit dhe për vlerësimin e profilit të riskut dhe zbulimin e abuzimeve. Përmirësimi i kontroll/auditit**

<sup>1</sup>Banka Botërore, treguesit janë marrë nga simulimet e ndërtruara në dokumentin Social Assistance Modernization Project.

<sup>2</sup> Si referenca 1 e kësaj faqeje

është e lidhur me objektivin B1 për sa i përket uljes së numrit të përfituesve pa aftësi të kufizuar në 10% nga 14% aktuale<sup>1</sup>.

Objektivi lidhet me krijimin e një sistemi vlerësimi që ofron monitorim, nxit përgjegjshmërinë, nxit rritjen e kapaciteteve profesionale dhe realizon marrëdhëniet ndër-institucionale. Kjo do të krijonte (a) një sistem koherent të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; dhe (b) një sistem integral të sigurimit të cilësisë dhe inspektimit, me qëllim parandalimin e abuzimeve. Gjithashtu, do të forcohen kapacitetet njerëzore në fushën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.

### **C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social**

Nëpërmjet politikave të mëposhtme dhe objektivave strategjike për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social, produkti që synohet deri më 2020 është që çdo individ dhe familje, si kategori në nevojë, në mënyrë progresive të ketë qasje të barabartë dhe të përfitojë nga një sistem funksional të shërbimeve të kujdesit social, bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit. Treguesit e performancës për zbatimin e këtyre parimeve dhe arritjen e objektivave si më poshtë, paraqiten të integruar në kapitullin e monitorimit.

Strategjia e mbrojtjes sociale do të ketë prioritet familjet dhe grupet e rrezikuara: Familjet me kryefamiljare gra; Familjet në rrezik përjashtimi, përfshirë romët; Fëmijët dhe të rriturit me aftësi mendore të kufizuara; Fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë dhe nuk shkojnë në shkollë; Fëmijët në konflikte ligjore; Fëmijët dhe gratë e prekura nga dhuna në familje; Të papunët afatgjatë; Individët e infektuar me HIV ose abuzues të substancave narkotike; Të moshuarit pa mbështetje.

**C1. Ngritja e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore në zonat e përzgjedhura deri në 2017 dhe në nivel kombëtar deri në 2020.** Do të ngrihen sistemet funksionale të shërbimeve të integruara të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore. Aktualisht, MMSR është duke punuar për të zhvilluar një Paketë Standarde të Shërbimeve, e ndjekur nga kostimi shërbimeve sociale. Pas përcaktimit të Paketës Bazë të Shërbimeve do të jetë e nevojshme të bëhet një analizë e hendekut për të identifikuar listën dhe llojet e shërbimeve që janë aktualisht në dispozicion në nivel vendor / rajonal. Kjo duhet të pasohet nga një vlerësim i strukturave që ofron shërbime sociale dhe kapacitetet e saj, në mënyrë që të ndihmojë planifikimin e duhur të një harte të shërbimeve sociale në shkallë kombëtare. Kjo do të shërbejë gjithashtu si një bazë e mirë për planifikimin e riorganizimit të shërbimeve në nivel vendor dhe kombëtar, pas zbatimit të reformës territoriale dhe strategjisë së decentralizimit. Paketa Bazë e Shërbimeve do të jetë mjeti kryesor për njësitë e qeverisjes vendore të sapoformuara në planifikimin dhe shpërndarjen e shërbimeve në komunitetet e tyre bazuar në nevojat e grupeve në rrezik. Në kuadër të ndarjes së re administrative ku tashmë kemi 61 bashki duhet të realizohet një analizë lidhur me numrin e punonjësve që duhet të kenë Sektorët e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (SVNR) për çdo bashki sipas numrit të banorëve.

Paketa do të përshtatet sipas nevojave individuale dhe do të zhvillohet duke u bazuar në ngritjen e *sektorëve të vlerësimit të nevojave dhe referimit (SVNR)*, si dhe të një *numri shërbimesh të ndryshme të kujdesit social*, të organizuara dhe ofruara nga subjekte publike

---

<sup>1</sup>Banka Botërore, treguesit janë marrë nga simulimet e ndërtruara në dokumentin Social Assistance Modernization Project.



dhe private në nivel qendror, rajonal dhe vendor. Këto shërbime do të mbulojnë nevojat e personit në bazë të vlerësimit dhe planit të kujdesit që bën SVN-ja.

Në kuadër të këtij objekti do të synohet de-institucionalizimi i shërbimeve të kujdesit rezidencial, ndërtimi dhe transformimi i institucioneve drejt modeleve me bazë familjen dhe komunitetin. Të transformimit të institucioneve të përkuajdesit social rezidencial drejt modeleve të reja alternative me bazë komunitare që synojnë mbështetjen e familjes dhe parandalimin e institucionalizimit. Shërbimet e kujdesit social do të jenë:

- Shërbime komunitare, shërbime mbështetëse për individët dhe familjet, qendra të kujdesit ditë për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara (për fëmijët në moshë shkollore program plotësues për arsimin gjithëpërfshirës), këshillim, programe formimi për prindërit, mbështetje e hershme për fëmijët në moshë parashkollore, kujdes në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda në fshat, shërbime të kujdesit në shtëpi për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, shërbimi zëvendësues i kujdestarit etj.
- Shërbime të kujdestarisë – familje kujdestare, familje me lidhje gjaku.
- Shërbime rezidenciale – streha, shtëpi strehimi, shtëpi rehabilitimi, shtëpi për strehim në grupe të vogla, institucione rezidenciale etj.

Shërbimet do të mund të kontrahohen nga organizatat jo-fitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve. Kjo do të zvogëlonte kostot e ngritjes dhe do të lejonte fleksibilitet në ofrimin e shërbimit.

Finalizimi i shportës së shërbimeve, kostimi dhe mundësia e prokurimit të shërbimeve sociale do t'i mundësojë bashkitë që të ofrojnë shërbime të kujdesit social sipas nevojave.

**C2. Rishikimi i funksioneve të planifikimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për nivele të ndryshme të qeverisjes vendore dhe modele të reja në zbatim deri në 2017.** Do të hartohet paketa e plotë mbi rolet dhe funksionet e institucioneve në nivel vendor dhe qendror mbi planifikimin, menaxhimin dhe shpërndarjen e shërbimeve sociale.

Duke pasur parasysh strategjinë e decentralizimit që po zhvillohet nga Qeveria Shqiptare, është vendosur që planifikimi dhe ofrimi i shërbimeve sociale të transferohet në nivelin territorial, me mbështetjen e MMSR dhe zyrave rajonale të SHSSH.

Zbatimi i objektivave dhe politikave të kësaj strategjie kërkojnë një shpërndarje të re të detyrave dhe përgjegjësisë midis pushtetit qendror dhe atij vendor. MMSR zhvillon politikën, legjislacionin, standardet për ofrimin e shërbimeve dhe përgatit sistemin për kontrollin dhe vlerësimin e tyre.

SHSSH do të jetë përgjegjës për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen teknike (p.sh. në lidhje me planifikimin vendor) në njësitë territoriale, si dhe për monitorimin dhe vlerësimin në lidhje me njësitë territoriale. Inspektorati do të luajë një rol të rëndësishëm në inspektimin e shërbimeve.

Në nivel vendor, bashkitë do të jenë përgjegjëse për vlerësimin dhe planifikimin e nevojave, si dhe shpërndarjen e shërbimeve.

Duhet të theksohet se këto role do të kërkojnë fuqizim të konsiderueshëm të gjitha agjencive të përfshira, duke përfshirë MMSR, SHSSH, Inspektoratit dhe Bashkitë. Të gjitha agjencitë

do të marrin role dhe funksione të reja dhe kjo do të kërkojë ndryshime institucionale, ngritjen e kapaciteteve dhe burimeve shtesë.

Një çështje kyçe për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social do të jenë mekanizmat e financimit. Financimi i shërbimeve të kujdesit social mund të përfshijë fonde nga buxheti qendror i shtetit, fondet e planifikuara nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat nga pronat dhe aktivitetet e tjera të bashkive, kontributet nga shërbime të kujdesit social të përfituesve, dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga partnerët e zhvillimit, organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë. Mekanizmi financiar duhet të sigurojë që burimet të jepen në mënyrë të drejtë nga qeveria qendrore dhe vendore, për të siguruar që shërbimet të jenë me kosto efektive.

**C3. Ngritja e sistemit të integruar të informacionit në nivel rajonal dhe qendror, për të identifikuar, referuar nevojat për shërbime të perkujdesit shoqëror deri në 2018.** Krijimi dhe zhvillimi i një Sistemi Menaxhimi Informacioni dhe një bazë të dhënash të integruar për përfituesit e shërbimeve të perkujdesit social. Sistemi do të integrohet me sistemet e menaxhimit të informacionit për përfituesit e NE dhe PAK në të gjitha nivelet.

**C4. Ngritja dhe fuqizimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve sociale në nivel lokal, rajonal dhe qendror deri në 2020.** Do të synohet përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe inspektimit nëpërmjet rishikimit, unifikimit, harmonizimit të standardeve të kujdesit social dhe hartimit të protokolleve për rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në nivel vendor, rajonal dhe qendror. Do të analizohet mundësia për krijimin e strukturave të reja të inspektimit. Do të synohet forcimi i kapaciteteve profesionale për rritjen e efikasitetit të inspektimeve.

**C5. Profesionalizimi i forcës së punës dhe ofruesve të shërbimeve sociale nëpërmjet krijimit të një sistemi të kualifikimit deri në 2020.** Do të rriten kapacitetet profesionale të punonjësve që punojnë drejtpërsëdrejti në shërbimet sociale nëpërmjet programeve të edukimit në vazhdim dhe masave të tjera që do të merren si vijon:

- Zhvillimi i përshkrimeve të punës;
- Vlerësimi i kapaciteteve të stafit ekzistues;
- Zhvillimi i kualifikimeve, duke përfshirë module në nivel universitar;
- Certifikimi i kualifikimeve, duke përfshirë edhe mundësinë e njohjes së atyre të marra paraprakisht.

Realizimi masave do përcaktohet me hollësi në Planin e Veprimit.

**C6. Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik për parandalimin e problemeve sociale dhe adresimin pranë shërbimeve sociale, nëpërmjet fushatave të komunikimit deri në 2018.** Do të synohet zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi rëndësinë dhe mundësitë e programit të mbrojtjes shoqërore. Në fushatën e ndërgjegjësimit do të përfshihen edhe ofruesit e shërbimeve, duke përdorur platforma të ndryshme mediatike, si media e shkruar, apo mënyrave të tjera të shpërndarjes së informacionit, për rastet ku individët dhe familjet nuk kanë akses në mediat elektronike apo interneti. Do të përdoren platforma elektronike, ku nëpërmjet internetit do të krijohen portale të posaçme, ose do të përdoren rrjetet sociale me qëllim promovimin e sistemit të shërbimeve shoqërore.

#### IV. BURIMET FINANCIARE

Kosto e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e masave administrative të kësaj strategjie dhe të planit të veprimit është rreth 825 milionë lekë. Burimet e përcaktuara për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për programin buxhetor “Përkujdesi Social” mbulojnë rreth 62% të koston së përllogaritur për këtë strategji. Kostoja financiare e mbuluar nga buxheti i miratuar i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për çdo vit buxhetor përkatës, është e përfshirë brenda parashikimeve të tavanëve të shpenzimeve buxhetore për periudhën afatmesme, e më tej. Nevojat për fonde për periudhën 2016-2018 janë programuar në përputhje me kuotat tavan të projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2016-2018). Burimet financiare nga donatorët mbulojnë rreth 22% të koston së strategjisë, përkatësisht rreth 96 milionë lekë nga Banka Botërore, 83 milionë lekë nga UNICEF dhe 565 mijë lekë nga UNDP. Hendeku financiar i pambuluar në buxhet prej 15,7%, është pjesë e bisedimeve me donatorët dhe përbëhet kryesisht nga kosto për aktivitete plotësuese.

Kostimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë është realizuar bazuar në metodologjitë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, më konkretisht duke konsideruar shpenzimet e projekteve të trupëzuara në produkte dhe ato jashtë projekteve. Një metodologji e tillë është në përputhje me sistemin e planifikimit buxhetor afatmesëm në Republikën e Shqipërisë sikurse parashihet në ligjin organik të buxhetit të shtetit dhe në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave (MF).

Kostimi dhe buxhetimi i planit të veprimit të kësaj strategjie është mbështetur në elementet si më poshtë vijon:

- Kostot për zbatimin e strategjisë konsiderojnë jo vetëm shpenzimet kapitale por edhe ato korente të cilat, edhe pse janë me peshë të ulët janë konsideruar për garantimin e kapaciteteve të nevojshme për implementimin e strategjisë.
- Kostot e financuara nga donatorët janë konsideruar si shpenzime kapitale edhe në rastin kur nga natyra janë korente (kualifikime, fushata komunikimi, seminare dhe konferenca etj.) në përputhje me udhëzimet përkatëse të MF.
- Buxhetimi i strategjisë është parashikuar brenda kornizës së një rritje ekonomike jo më pak se 2.5% në vit në terma reale. Kjo normë rritje bën të mundur që në terma nominale buxheti i programit të përkujdesit social, ku parashkruhet plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, të rritet mesatarisht 4 - 5% çdo vit për periudhën 2015-2020.

Tab. 4.1: Buxheti i nevojshëm, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

<b>Politikat sektoriale</b>	A. Buxheti nevojshëm (Lekë)	B. Buxheti Shtetit i planifikuar (Lekë)	C. Donatorë (Lekë)	D. Hendek financiar (Lekë) D=A-(B+C)
<b>Objektivat</b>				
<b>A Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë.</b>	<b>283,829,240</b>	<b>215,136,600</b>	<b>46,288,940</b>	<b>22,403,700</b>
A1. Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës të Ndihmës Ekonomike nëpërmjet targetimit më të mirë të familjeve të varfëra.	238,332,440	181,603,500	43,953,940	12,775,000
A2. Modernizimi skemës së Ndihmës Ekonomike me anë të administrimit të regjistrit elektronik kombëtar dhe	31,558,100	31,558,100	-	-

sistemit të pikëzimit, duke arritur që 95% përfituesve të jenë përzgjedhur nëpërmjet këtyre instrumenteve deri në vitin 2017.				
A3. Rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndhmës Ekonomike.	9,554,000	1,789,000	1,770,000	5,995,000
A4. Përmirësimi i shërbimeve të kontrollit/auditit për të reduktuar numrin e abuzimeve.	1,323,700	-	-	1,323,700
A5. Transformimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë aktive riintegrimi nëpërmjet krijimit të paketës për krijimin e mundësive për punësim, duke rritur përfshirjen në politikat aktive të tregut të punës në 5% të përfituesve të Ndhmës Ekonomike deri në 2017.	3,061,000	186,000	565,000	2,310,000
<b>B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara.</b>	<b>267,094,550</b>	<b>193,347,500</b>	<b>51,336,600</b>	<b>22,410,450</b>
B1. Reformimi i sistemit të vlerësimin të personave me aftësi të kufizuar deri në 2017, duke vënë në zbatim sistemin e ri të vlerësimin sipas “Modelit Social” dhe duke ulur përqindjen e rasteve abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar në 10%.	53,129,350	8,064,500	36,300,600	8,764,250
B2. Rritja e transparencës së skemës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet ngritjes së regjistrin elektronik PAK, duke e vënë në funksion këtë regjistër në 90% të njësive të qeverisjes vendore në rajonet e përzgjedhura deri në 2017.	210,557,100	185,264,000	15,036,000	10,257,100
B3. Krijimi i një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në Cash, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuar deri në 2020.	-	-	-	-
B4. Ngritja dhe forcimi i mekanizmit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve PAK në nivel vendor dhe qendror, duke garantuar deri në 2017 gjenerimin e raporteve tremujore të performancës së skemës për politik-bërësit dhe për vlerësimin e profilit të riskut dhe zbulimin e abuzimeve.	3,408,100	19,000	-	3,389,100

<b>C. Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social.</b>	<b>273,534,500</b>	<b>105,729,750</b>	<b>83,319,250</b>	<b>84,485,500</b>
C1. Ngritja e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social në njësitë e qeverisjes vendore në zonat e përzgjedhura deri në 2017 dhe në nivel kombëtar deri në 2020;	52,273,750	1,805,500	50,194,750	273,500
C2. Rishikimi i funksioneve të planifikimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për nivele të ndryshme të qeverisjes vendore dhe modele të reja në zbatim deri në 2017.	6,002,500	-	6,002,500	-
C3. Ngritja e Sistemit të integruar të Informacionit në nivel rajonal dhe qendror, për të identifikuar, referuar nevojat për shërbime të përkujdesit shoqëror deri në 2018.	194,728,280	103,592,750	7,049,000	84,086,500
C4. Ngritja dhe fuqizimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve sociale në nivel lokal, rajonal dhe qendror deri në 2020.	5,419,050	-	5,293,550	125,500
C5. Profesionalizimi i forcës së punës dhe ofruesve të shërbimeve sociale nëpërmjet krijimit të një sistemi të kualifikimit deri në 2020.	8,522,950	331,500	8,191,450	-
C6. Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik për parandalimin e problemeve sociale dhe adresimin pranë shërbimeve sociale, nëpërmjet fushatave të komunikimit deri në 2018.	6,588,000	-	6,588,000	-
<b>Totali</b>	<b>824,458,290</b>	<b>514,213,850</b>	<b>180,944,790</b>	<b>129,299,650</b>

## V. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Strategjia e Mbrojtjes Sociale do të jetë pjesë integrale e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), dhe mekanizmave të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBAM), të përcaktuara nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Monitorimi i strategjisë do të përfshijë analizimin e rregullt të burimeve, produkteve dhe rezultateve të ndërhyrjeve në politika. Ajo do të bazohet në një sistem të mbledhjes së informacionit dhe analizës së treguesve të monitorimit siç është paraqitur në detaje në pikën 6 të këtij Kreu, si dhe në Shtojcën 1.

Strategjia do të monitorohet nga Grupi i Menaxhimit të Politikave të Integruara, që do të sigurojë përshtatjen e masave për arritjen e objektivave strategjike, duke marrë parasysh risqet e mundshme. Në këtë mënyrë do të rritet efikasiteti dhe efektiviteti të qeverisjes.

Për garantimin e zhvillimit dhe zbatimit të objektivave strategjike të Mbrojtjes Sociale (referuar në këtë strategji) do të:

- monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;

- rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat (kihen parasysh këtu risqe dhe rreziqe) dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progres raporteve të Bashkimit Evropian;
- sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integritetit të politikave dhe masave të Mbrojtjes Sociale në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) do të ketë përgjegjësinë për të sistemuar informacionin e monitorimit për ta prezantuar në Qeveri.

## **1. Sistemi i informacionit dhe mbledhjes së të dhënave**

Objektivat dhe rezultatet e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale do të gjejnë zbatim nëpërmjet Planit të Veprimit dhe dokumentet e tjera të planifikimit tematik. Zbatimi i Planit të Veprimit do të monitorohet me anë të treguesve të performancës që masin rezultatet e çdo veprimtarie/mase dhe caktojnë përgjegjësitë për implementimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare.

Kuadri i ri strategjik ka për qëllim të realizojë një proces të gjerë dhe efikas të monitorimit bazuar në një sistem të mirë-organizuar raportimi. Procesi i monitorimit do të fillojë në vitin 2016 dhe do të zbatohet nga strukturat e specifikuar në pikën 3 të këtij Kreu.

Monitorimi do të kryhet çdo vit dhe raportet e monitorimit dhe vlerësimit do të hartohen dhe miratohen në afate 1 vjeçare. Mënyra e raportimit dhe konsultimit të raporteve të monitorimit përcaktohet në pikën 2 të këtij Kreu.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioritetëve në fusha të ndryshme, dhe të informojnë për politikat e vendit të lidhura me mbrojtjen sociale.

Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave.

Përveç këtij monitorimi të vazhdueshëm, progresi në arritjen e qëllimeve të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale do të matet nëpërmjet dy ushtrimeve të vlerësimit, si më poshtë:

- Një vlerësim afatmesëm, që do të zhvillohet në fund të vitit 2017, do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë për ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse qëllimet janë të qenësishme, duke krahasuar kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme. Bazuar në këtë vlerësim, mund të rishikohen aktivitetet e planit të veprimit për të arritur objektivat e vendosura në strategji.
- Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë Strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm. Do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme,

duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive të tregut të punës.

Të dhënat administrative për Ndhmën Ekonomike, Aftësinë e Kufizuar dhe Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror do të gjenerohen nga regjistrat përkatës elektronikë (ose informacione në rrugë administrative), si për numrin e përfituesve, ashtu dhe për rastet abuzive të evidentuara. Po në këtë kuadër do të shërbejnë edhe raportet e vlerësimit të impaktit sipas planit të veprimit në Shtojcën 1.

## **2. Mënyra e raportimit dhe konsultimit të raporteve të monitorimit**

Instrumenti kryesor në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të mbrojtjes sociale do të jetë Raporti Vjetor të Mbrojtjes Sociale, i përgatitur nga Drejtoria e Përkujdesit Shoqëror dhe Shërbimeve të Integruara në MMSR, në bashkëpunim me SHSSH. Raporti do të hartohet dhe miratohet brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës së vitit të monitoruar. Ky raport do të:

- Vlerësojë strategjinë e Mbrojtjes sociale me fokus progresin e arritur në përmbushjen e masave dhe veprimtarive nga njëra anë dhe e treguesve të monitorimit nga ana tjetër;
- Identifikojë çështje të reja apo ato ndërvepruese, të cilat mund të trajtohen përmes një qasjeje më të koordinuar;
- Raportoje mbi pikëpamjet/këndvështrimet e aktorëve në nivel kombëtar dhe lokal.

Raporti do të prezantohet në Njësinë e Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik në Departamentin e Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj në Kryeministri.

## **3. Strukturat e përfshira në raportim dhe konsultimin e raporteve të monitorimit**

Institucionet dhe strukturat e përfshira në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjisë së mbrojtjes sociale janë:

- Grupi ndër-ministral i Mbrojtjes Sociale, i kryesuar nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe me pjesëmarrjen e titullarëve të tjerë brenda kësaj ministrie dhe ministrive të tjera të linjës;
- Grupi i Menaxhimit të Politikave të Integruara, që do të sigurojë përshtatjen e masave për arritjen e objektivave strategjike, duke marrë parasysh risqet që duhet të menaxhohen në vazhdimësi;
- Drejtoria Përkujdesit Social dhe Shërbimeve të Integruara:
  - MMSR dhe njësitë e saj apo të ndërvarura (NJQV, SHSSH, Zyra Rajonale, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore)

Agjenci të tjera të pavarura qeveritare, në përgjithësi mbështesin këto aktivitete përmes punës kërkimore dhe këshilluese në fushat kryesore të mbrojtjes sociale.

## **4. Mënyra e raportimit dhe konsultimit të raporteve të monitorimit me aktorët joqeveritarë**

Strukturat sipas pikës 3 të këtij Kreu do të kryejnë vlerësimet që do të shërbejnë për raportimin dhe konsultimin me aktorët jo-qeveritarë. Raportimi do të jetë periodik një vjeçar

dhe do të vlerësojë përmbushjen e masave të planit të zbatimit dhe treguesve të monitorimit. Raporti do të përfshijë kërkime nga ekspertë të pavarur dhe dokumente politike për të vlerësuar, nxjerrë përfundime dhe sugjeruar iniciativa të informuara (për çdo vit). Gjithashtu, do të mbledhen dhe analizohen të dhëna afat-gjata dhe sektoriale.

DPSHSHI në MMSR do të hartojë dhe zbatojë Platformë të Komunikimit Publik (PKP) në lidhje me reformat që do të ndërmerren, ku ndër të tjera do të shpërndahen raportet e monitorimit të ecurisë, të kuptueshme për opinionin publik. Raportet do të përfshijnë nivelin kombëtar e lokal dhe do të evidentojnë praktikatat e mira për t'u replikuar ku është e mundur.

MMSR do të punojë ngushtësisht me Zyrën e Informimit të Qeverisë për të siguruar një qasje të standardizuar të aktiviteteve të komunikimit në fushën e mbrojtjes sociale. Komunikimi do të mundësojë që publiku të njohë:

- Ndërhyrjet në fushën e mbrojtjes sociale, investimet dhe rezultatet në nivele e departamente të ndryshme të qeverisë.
- Tendencat dhe sfidat e vazhdueshme lidhur me varfërinë dhe mbrojtjen sociale, si dhe ndikimin e tyre tek grupet e cënueshme.

## **5. Struktura të përfshira në raportim dhe konsultim**

Strukturat e përfshira në raportim dhe konsultim do të jenë sipas pikës 3 të këtij Kreu.



## 6. Treguesit e monitorimit

Treguesve Monitorimit	Institucioni përgjegjës	Njësia	Burimi	Baseline 2012		Viti i fundit ne dispozion		Synimi 2017	Synimi 2020	Periodiciteti
				2012	Vlera	Viti	Vlera	Vlera	Vlera	
<b>A. Zbutja varfërisë</b>										
Mbulimi i skemës për familjet e varfra dhe ekstremisht te varfra	MMSR	% e popullatës së varfër ekstreme që marrin NE* sipas gjinisë	INSTAT, MMSR	2012	24.6%	2012	24.6%	54.5% (total) 22% (femra)	100 % 50% (femra)	2 vjeçar
	MMSR	% e popullatës së varfër që marrin NE* sipas gjinisë	INSTAT, MMSR	2012	19.5%	2012	19.5%	40 % (total) 20% (femra)	60%(total) 30% (femra)	2 vjeçar
	MMSR	Nr. përfituesve të Ndihmës Ekonomike gra kryefamiljare.	MMSR	2012	7000	2014	8000 (14%)	9000 (12%)	10.000 (+11%)	1 vjeçar
Shenjëstrimi i skemës për familjet e varfra dhe ekstremisht te varfra	MMSR	% e shpenzimeve të NE që shkon për të varfrit ekstreme*	INSTAT, MMSR	2012	15.2%	2012	15.2%	36.9%	38%	2 vjeçar
	MMSR	% e shpenzimeve të NE që shkon për të varfrit*	INSTAT, MMSR	2012	31.4%	2012	31.4%	62.8%	62.8%	2 vjeçar
	MMSR	% e përfituesve në varfëri ekstreme që marrin NE mbi totalin e	INSTAT, MMSR	2012	16.6%	2012	16.6%	33.2%	32.2%	2 vjeçar

		përfituesve*								
	MMSR	% e përfituesve në varfëri që marrin NE mbi totalin e përfituesve*	INSTAT, MMSR	2012	33.2%	2012	33.2%	62.8%	64%	2 vjeçar
Riintegrimi social i përfituesve të Ndihmës Ekonomike	MMSR	Pjesa e përfituesve të ndihmës sociale referuar politikave të tregut të punës aktive (PTPA) <sup>+</sup> sipas gjinisë	MMSR	2012		2014	1.4% (total) 1.2% femra	5% (total) 2% femra	10% (total) 5% femra	2 vjeçar
<b>B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara <sup>1</sup></b>										
Përfshirja dhe mbulimi më i mirë i personave me aftësi të kufizuara.	MMSR	Nr. personave përfitues të pagesave të aftësisë së kufizuar sipas gjinisë	MMSR	2012	89,300 persona me aftësi të kufizuar (total) 7,000 (femra 0-18 vjeç)	2014	89,903 (total) persona me aftësi të kufizuar  7,819 (femra 0-18 vjeç)	92,000 (total) 8,100 (femra 0-18 vjeç)	94,000 8,500 (femra 0-18 vjeç)	1 vjeçar
Zbulimi i përfituesve në mënyrë të padrejte	MMSR	Pagesat sipas % së përfituesve të ndihmës së aftësisë së kufizuar që raportohen për "mungesë të	INSTAT, MMSR	2012	14%	2012	14%	14%	10%	1 vjeçar

<sup>1</sup>Është teknikisht e pamundur të vlerësohet përjashtimi / përfshirja e gabimeve me pagesat e aftësisë së kufizuar, prandaj nuk rekomandohet ndonjë tregues në këtë fushë.

		aftësisë së kufizuar funksionale’*								
<b>C. Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social</b>										
Rritja mbulimit me shërbime shoqërore për individët dhe familjet në nevojë	MMSR	% e popullsisë me qasje në paketën bazë të shërbimeve të kujdesit social, sipas gjinisë.	MMSR	2012	0.002%	2014	0.002%	0.008% (total) 0.004% femra	0.5% 0.25% femra	1 vjeçar
Zbatimi i Deinstitutionalizimi dhe decentralizimi	MMSR	Nr. i fëmijëve (0-18 vjeç) në kujdes institucional rezidencial, sipas gjinisë.	MMSR	2012	306 (total) 140 femra	2014	214 (total) 99 (femra)	300 (total) 140 (femra)	320 (total) 150(femra)	1 vjeçar
	MMSR	Nr. i fëmijëve (0-18 vjeç) në kujdesin institucional komunitar/ditor, sipas gjinisë	MMSR	2012	205 (total) 95 (femra)	2014	190 (total) 93 (femra)	200 (total) 100 (femra)	250 (total) 150 (femra)	1 vjeçar
	MMSR	Nr. i fëmijëve (0-18 vjeç) në shërbimin e kujdestarisë.	MMSR	2012	97	2014	127	150 (+18%)	170 (+13%)	1 vjeçar
	MMSR	Nr. i përfituesve në qendrat e zhvillimit (0-25 vjeç) në kujdes institucional rezidencial, sipas gjinisë.	MMSR	2012	254 (total) 97 (femra)	2014	310 (total) 108 (femra)	342 (+10%) 120 (femra)	370 (+8%) 150 (femra)	1 vjeçar
	MMSR	Nr. i përfituesve në qendrat e zhvillimit (0-25 vjeç) në kujdes					73(total) 30 (femra)	80 (+10%) 40 (femra)	86 (+7%) 50(femra)	

		institucional komunitar/ditor, sipas gjinisë.	MMSR	2012	207 (total) 78 (femra)	2014				1 vjeçar
MMSR		Nr. familjeve në nevojë në shërbim emergjence.	MMSR	2012		2014	53	53	55	1 vjeçar
MMSR		Nr. i të moshuarve në kujdesin institucional rezidencial publik, sipas gjinisë.	MMSR	2012	261 (total) 60 (femra)	2014	171 (total) 62 (femra)	180 (total) 70 (femra)	190 (total) 80 (femra)	1 vjeçar
MMSR		Nr. i të moshuarve në kujdesin komunitar/ditor, sipas gjinisë.	MMSR	2012	500 (total) 115 9femra)	2014	314 (total) 78 (femra)	320 (total) 100 (femra)	340 (total) 150 (femra)	1 vjeçar
MMSR		Nr. i grave dhe vajzave në rrezik trafikimi të trajtuara me shërbime rezidenciale	MMSR	2012	26	2014	32	40	45	1 vjeçar
MMSR		Nr. i grave dhe vajzave të dhunuara që marrin shërbime rezidenciale	MMSR	2012	32	2014	40	45	60	1 vjeçar
MMSR		Nr. shërbimeve të rishikuara ose adaptuara	MMSR	2012	187 <sup>1</sup>	2014	201	216	218	2 vjeçar

<sup>1</sup> Numri i shërbimeve të përkujdesit social të tipologjive të ndryshme (komunitare, rezidenciale, ditore etj) që ofrohen nga institucionet e përkujdesit social publik dhe subjekte jo-publike të licencuara

Rritje kapaciteteve dhe profesionalizmit	MMSR	Nr. trajnimeve sipas gjinisë	MMSR	2012	20 (total) 15 (femra)	2014	30(total) 20 (femra)	35(total) 25 (femra)	40 (total) 30 (femra)	1 vjeçar
--	------	------------------------------	------	------	--------------------------	------	-------------------------	-------------------------	--------------------------	----------

\* Banka Botërore, treguesit janë marrë nga simulimet e ndërtuara në dokumentin Social Assistance Modernization Project, lidhur me modernizimin e NE

\*\* Instat, Pas publikimit të shifrave të plota të popullsisë për vitet 2001-2014 në maj 2014, është rishikuar seria kohore e të dhënave të AMNJ 2005, 2008, 2012.

+ = Treguesi i Startegjisë për Punësim dhe Aftësi

Për mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e tyre, për të pasur një kuadër të qarte analize dhe përpunimi të këtyre të dhënave kërkohet që të unifikohet një database me statistika të përcaktuara për çdo njësi vendore, sipas prioriteteve të mësipërme. Baza ligjore duhet rishikuar dhe duhet të ngrihet një sistem i dixhitalizuar për marrjen e të dhënave bazë për Ndihmën Ekonomike, PAK dhe shërbimet shoqërore.